

XHAFERR MATUKA

TAKIM në LUFTË

Tregime

BIBLIOTEKA E SHËTIT GJIROKASTËR
85H-32
M40



851983-32

M 40

XHAFERR MATUKA

TAKIM NË LUFTË

(TREGIME)

~~54524~~



260F

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PRANIMI NË PARTI

Bëhej mbledhja e organizatës së partisë. Pika e parë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i kërkesës së shokut... për t'u pranuar në parti. Të gjithë ishin ulur nëpër stola dhe po dëgjonin me vëmendje sekretarin e organizatës që lexonte kërkesën e shokut dhe dokumentat e tij. Ai lexonte me ngadalë, e me kujdes, që të mos i shpëtonte asgjë nga ato që qenë shkruar aty.

— Kush ka pyetje? — na u drejtua sekretari, pasi mbaroi së lexuari dokumentat, duke i mbështjellë ato për t'i vënë mbi tavolinë.

Asnjë nuk u nxitua të merrte fjalën. Pasi kaluan nja dy minuta në heshtje, u çua një shok e ju drejtua sekretarit:

— Të na thonë shokët që i kanë dhënë rekomandimet, si e kupton ai luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit.

Pyetja u duk pak si jo e rregullt, prandaj disa kthyen kokat e shikuan shokun që bëri këtë pyetje.

— Më mirë le të na thotë vetë ai, pse na u dashka që të flasin të tjerët për të. Më mirë se ai veten e tij, askush nuk mund ta dijë, — foli një shok që u ulur para meje.

— Jo, unë mendoj, që para se të flasë shoku... le të na thonë rekomanduesit si e kanë parë e çmuar ata përgatitjen ideologjike të tij, — nguli këmbë prapë ai që bëri pyetjen.

U zhvilluan diskutime të gjata e të hollësishme mbi shokun që kishte bërë kërkesën për t'u pranuar në parti. Folën ata që i kishin dhënë rekomandimet, foli ai vetë, pastaj dhanë mendime edhe të tjerët. Më në fund shoku u pranua kandidat për anëtar partie. Të gjithë i uruan atij suksese në punën si komunist, duke e përçafuar e duke i shtrënguar dorën.

Mbledhja kishte mbaruar. Unë me një shok, po zbrisnim bashkë poshtë një kodre duke kaluar në një rrugë të ngushtë e të thyer. Unë ecja përpara pa folur dhe, duke parë se si era përkundte lehtë barërat e përzhitura nga vapa, po mendohesha për zhvillimin e mbledhjes së partisë.

Heshtjen e theu shoku që vinte pas.

— Ajo pyetja në organizatë për rekomanduesat m'u duk si e çuditshme.

— Pse? — e pyeta unë. — Mua m'u duk krejt normale.

— Se duke pasur në mes të mbledhjes, njeriun që kërkon të pranohet në parti, t'i thua të na thonë të tjerët për të, se ç'mendon ai e si i kupton gjërat.

— Nuk është ashtu. Ai vetë do të flasë, dhe ne do ta themi mendimin tonë për atë shok. Por ata që i japin rekomandimin e njohin më në thellësi se ne të tjerët, dhe pikërisht ata duhet të na japin një spjegim për të gjitha cilësitë e atij që kërkon të futet në parti.

— Ç'është e drejta, më tha, kërkesat për ata që duan të futen në parti janë të forta.

— Ashtu duhet të jenë. Organizata duhet të jetë filtër për të mos lejuar që të bien llozhëra në parti.

— Ju e keni pasur më lehtë për t'u pranuar në parti, — tha ai, — atëhere s'duhet të kenë kërkuar si sot.

— E ke gabim, — ju përgjegja.

Ndalova, nxora paqetën, i dhashë një cigare atij, ndeza edhe një vetë.

— E ke gabim, — i thashë prapë. — Atëhere ka qenë më vështirë të pranoheshe anëtar partie. E di ti që, kishte partizanë, që luftonin e hiqnin të zitë e ullirit, rrinin pa bukë e në të ftohtë, hidheshin disa herë në sulm e plagoseshin, e megjithatë në parti nuk ishin. Duhet të dish edhe një gjë tjetër: kishte edhe ndonjë që pas provash të shumta e pas një pune të madhe nga shokët e celulës, kur pranohej në parti, fyhej. «Po pse deri tashti s'kam qenë komunist? — pyeste ai. Unë e di se jam komunist që kur dola partizan!» Kështu që, pati shokë trima që e filluan luftën në malet e Kurveleshit dhe e mbaruan në malet e Kosovës e prapëseprapë në parti nuk u pranuan dot, ose u pranuan vonë.

Në mbrëmje, duke kujtuar bisedën me shokun pas mbledhjes së partisë, mendimet, padashur, më shpunë njëzet e pesë vjet më parë...

* * *

Gjatë gjithë ditës bëmë një luftë të rreptë me gjermanët. Në mbrëmje vonë ata u tërhoqën, kurse ne u ndamë nëpër shtëpitë e fshatarëve, që kishin

mbetur pa u djegur. Ishte mesi i një nate sterrë të zezë. Unë isha roje në majën e një bregoreje të veshur me dushk të shkurtër e mare, që ngrihej midis fshatit ku ndodheshin partizanët dhe armikut. Yjet lart në qiell po shkëlqenin përmes copërave të reve. Frynte një erë e lehtë, e cila i bënte të fëshfërinin butë fletët nëpër degë.

Me pushkën e hedhur në sup po shikoja me kujdes aty para ku kalonte një rrugë e ngushtë dhe andej tutje nga ana e armikut. Herë pas here, që nga kodrat përtej, ku ishin gjermanët, ngjiteshin lart në qiell raketa të kuqe e blu, dhe dëgjoheshin breshëri të gjata të mitralozave «Sharrës», fishekët me ngjyra të të cilëve dukeshin si yje që ndiqnin njëri — tjetrin përmes errësirës. Në këto e sipër m'u duk sikur majtas meje lëviznin degët. Mbajta vesh më me kujdes, dhe u binda se në atë drejtim me të vërtetë diçka kishte. Hoqa pushkën nga supi, e mora në duar, i ktheva sigurecën, dhe bëra disa hapa andej nga dëgjohej lëvizja. S'vonoj shumë dhe dallova, përmes errësirës, hijen e një njeriu që po afrohej me kujdes.

— Ndal, mos luaj! — e urdhërova. — Ai ndaloi.

— Parullën?

— Kurveleshi. Kundër parullën?

— Korça.

Ai u afrua. Ishte përgjegjësi i rinisë së çetës, Bilali. Me të ishim njohur në çetë. Kur unë dola partizan, ai ndodhej aty. Kish një trup të shkurtër, por të lidhur e një fytyrë të hequr zeshkane, me sy të zez e të gjallë, që tregonin zgjuarësi. Ai akoma nuk i kishte mbushur njëzet vjeçët, por ish bërë burrë para kohe. Shumë herë, veç punës po-

litike, ai na spjegonte edhe ngjarje nga gjeografia e probleme historie. Edhe për trimëri shokët i kishte të rrallë. Bilali që i dashur me të gjithë dhe që gati të hiqte pallton e tij e të ta jepte ty, po ta shikonte që ti mërdhije shumë. Po ama, po të gabojë, e sidomos të shkelje, qoftë edhe një thua, disiplinën partizane, ai s'ta falte. Dhe jo vetëm kaq, po i pari ngrihej para çetës e pasi e analizonte fajin, duke e parë të lidhur me politikën, e pasi t'i numëronte të gjitha gabimet e fajet që mund të kishte bërë edhe më parë, propozonte dënim të ashpër për ty që kishte gabuar.

— Vdekje fashizmit! shoku Qazim, — më përshëndeti me zë të ulët.

— Liri popullit! — ju përgjegja, dhe me vete mendova: «Ç'do ky këtu tashti në mes të natës?»

— Ç'kemi, a ke ftohtë?

— Jo dhe aqë.

— Duket gjë andej nga gjermanët?

— Qëllojnë me raketa e mitraloza.

Ai u kthye andej nga kodrat përballë ku ishte armiku dhe po shikonte.

— Luftë e fortë u bë sot, apo jo?

— Me të vërtetë u kacafytëm keqas me ta, — i thashë unë. — Po edhe ata, ama, qëndruan si derrat derisa u grinë e u bënë lakra.

— Po të luftojmë, ashtu si sot, e të asgjësojmë në çdo luftë aq armiq sa çfarosëm në këtë betejë, ne shpejt do të çlirojmë Shqipërinë, dhe do të merremi me ndërtimin e Shqipërisë së re të popullit, — tha ai. Unë nuk ju përgjegja, po mendohesha për ato që dëgjova nga Bilali, dhe po shikoja tutje përmes errësirës andej nga ishte armiku.

— Ti, shoku Qazim, a e ke të qartë qëllimin e luftës sonë? — m'u drejtua ai mua, papritur dhe u kthye nga unë. — Ja, për shembull përse lufton ti?

— Unë luftoj që të çliroj Atdheun nga okupatori dhe tradhëtarët, — ju përgjegja ngadalë dhe pastaj prita nga ai, heshta që të kuptoja nëse kjo përgjigje e kënaqi, kësaj radhe, sepse e dija që gjatë përgjigjeve tona, ai e plotësonte pyetjen.

— Mirë, ashtu është. Po kur ta çlirojmë Shqipërinë, pastaj ç'do të bëjmë?

— Do të jetojmë të lirë.

— Po a do të na lenë të jetojmë të lirë?

— Kush?

— Armiqtë.

— Po ata ne do t'i kemi mundur.

— Jo të gjithë.

— Në qoftë se s'i kemi mundur të gjithë, qysh të themi se e çliroam Shqipërinë?

Bilali më spjegoi gjerë e gjatë për këtë çështje. Ai, midis të tjerave, më tha: «Çlirimi i Shqipërisë nga okupatorët dhe tradhëtarët është etapa e parë e luftës sonë, më vonë fillon një luftë tjetër më e vështirë dhe po aq e rëndësishme, kjo është lufta për të ngritur një Shqipëri të re, të popullit, ku punëtorët e fshatarët të jenë zotër të vendit, e jo pasanikët e bejlerët». Pastaj, pasi u bind se fjalët e tij i kuptova drejt, për një çast heshti.

Në këtë kohë gjermanët hodhën një raketë të kuqe, e cila, pasi u ngjit deri në një farë lartësie, u përkul e u kthye pingul poshtë, pastaj ra në tokë pa u djegur plotësisht. Më pas, që nga kupa e qiellit u shkëput një yll, i cili, duke lënë pas një bisht

të ndritshëm, rrëshqiti poshtë dhe u fsheh prapa një mali.

— Do të jetë vrarë ndonjë trim, thashë unë.

— Nga e di ti?

— U këput një yll. Kështu thonë në fshat kur këputet ndonjë yll.

— Pse u beson ti atyre? — më pyeti Bilali menjëherë.

— Nuk u besoj — ju përgjegja — po ai yll më kujtoi fjalët e plakave.

Vazhduan disa sekonda heshtje.

— Sa vjeç je — më pyeti befas.

— Gjashtëmbëdhjetë.

— Do të të bëj edhe një pyetje, shoku Qazim, — m'u drejtua ai. — Ta zëmë se zumë dy robër, njëri është fshatar i pasur, tjetri fshatar i varfër. Ty të themi t'i gjykosh e t'u japësh dënimin. Si do t'i dënoje?

— A kanë bërë faj të njëllajtë?

— Faji është i njëllajtë, për shembull, të dy janë hedhur në rreshtat e ballit dhe kanë luftuar kundër nesh.

— Të dy do t'i vë në plumb.

— Nuk do të bësh asnjë dallim?

— As edhe një.

— Po nuk e kupton ti se ai i pasuri lufton kundër nesh, sepse ne jemi ngritur kundër klasës së tij, kundër pasurisë së tij dhe kundër privilegjeve të tij, dhe se ai është përfaqësues i asaj bote të vjetër, të cilën ne po e shkatërrojmë? Kurse ai i varfri lufton kundër nesh, domethënë kundër klasës së tij, sepse është gënjyer e është bërë vegël në duart e të pasurve dhe të armiqve? Prandaj nuk do të bëje dallim midis këtyre të dyve kur fajti është i njëllajtë?

— Plumbat e të dyve ne na vrasin, prandaj edhe plumbat tanë, të dy do t'i vrasin.

— Jo, shoku Qazim, më tha ai i inatosur, plumbat e të dyve ne na vrasin, por ne nuk do t'i vrasim të dy, ne do të bëjmë dallim midis tyre, do të dënojmë më rëndë atë përfaqësues të asaj klase që është e betuar kundra nesh, kurse shokët e klasës që janë hedhur me armikun, duhet t'i shkëputim andej. Atyre duhet t'u spjegojmë rrugën e tradhëtisë, që kanë marrë. Njerëzve që s'i kanë lyer duart me gjak kundër nesh e kundër popullit, mund t'u japim edhe pushkë që të luftojnë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve për të larë më mirë se kudo tradhëtinë e tyre.

Pastaj Bilali më spjegoi gjërë e gjatë mbi luftën e klasave dhe si duhet ta kuptonim e ta zbatonim atë ne në konditat e Luftës nacionalçlirimtare. Mua më bënë shumë përshtypje ato që më tha ai, dhe ç'është e vërteta, që atëhere kuptova se midis njerëzve duhej bërë një diferencim, i cili ishte i domosdoshëm për gjykimin e problemeve të ndryshme, që kishin të bënin me njerinë. Ai më spjegoi me ngadalë e me shembulla nga jeta jonë, e partizanëve, e fshatarëve dhe e punëtorëve. Kështu që me të drejtë edhe midis tradhëtarëve duhej të bëhej **dallim**.

Me kaq biseda jonë, e papritur për mua, mori fund. Ai pasi ndejti dhe pak, më tha «mirupafshim», dhe me automatik në dorë u largua përmes bimësisë së dendur të bregores, kurse unë vazhdova të qendroj roje, duke ruajtur e përgjuar armikun që kisha përpara dhe duke shkuar edhe një herë ndër mend bisedën që pata me Bilalin.

Kaluan disa ditë. Kishim zënë pritë në mes të

disa shkëmbinjve mbi një rrugë automobilistike e po prisnim të kalonte një autokolonë gjermane. Unë isha shtrirë barkaz pas një guri të madh e po shikoja larg, atje ku fillonte të dukej rruga e bardhë gjarpërore, që vinte drejt nesh. Dy granada dore i kisha vënë aty para: djathtas e majtas, po ashtu pas gurëve, qenë shtrirë partizanët e tjerë e po prisnin. Njëri — tjetrin e shikonim me vështirësi, sepse na pengonin gurët që ishin midis nesh dhe sfakat e dendura që kishin mbirë nëpër sheshet e vogla midis gurëve. Ta shikoj një herë fyellin e tytës, mendova me vete, se mos i ka hyrë gjë brenda, dhe hoqa shulin e po shikoja përmes fyellit. Në këtë kohë që nga prapa, me hapa të lehtë, vjen aty e shtrihet majtas meje pas një guri, përgjegjësi i rinisë, Bilali. «Prapë do të fillojë nga pyetjet si atë natë, mendova, dhe do më zërë në fjalë».

— Shoku Qazim, tashti gjete kohën ta pastrosh, pushkën? — më tha ai me një ton qortonjës, dhe vuri automatikun e tij para vetes me tytë në drejtim nga prisnim armikun.

— Jo, shoku Bilal, e kam pastruar, po e shikoj mos i ka hyrë ndonjë shkop a gjë në grykë.

Ai s'foli më, u kthye përpara dhe, ashtu si të tjerët, i mbërtheu sytë në fillimin e rrugës automobilistike.

U duk maqina e parë, pastaj një tjetër dhe... Maqinat vazhdonin me intervale të shkurtra të dilnin njëra pas tjetrës, duke lënë prapa shtëllungat tymi.

— Kujdes, mos bëni asnjë lëvizje, mos diktoheni, përgatitni armët! — u transmetua nga njeri shok

te tjetri, që nga e djathta në të majtë, urdhëri i komandës së çetës.

Maqinat po afroheshin me shpejtësi. Tashti në karroceritë e tyre dalloheshin ushtarët me helmëta në kokë dhe mitralozat e vendosur mbi kabina gati për qitje.

Prisnim akoma sinjalin e komandës së çetës për hapjen e zjarrit. Vendi ku ndodheshim unë dhe Bilali ishte nja njëqind metra mbi rrugë dhe ishte qendra e çetës, djathtas e majtas shokët i largoheshin pak xhadesë.

Bilali më shikonte me kujdes, ai mendohej që të mos i shpëtonte asnjë nga lëvizjet dhe veprimet e mia. Por në të njëjtën kohë ai mendohej, që unë të mos ndiqja vëzhgimet e tij.

«Pam!» U dëgjua e shtëna e parë e pushkës partizane që andej nga krahu i djathtë. Në atë kohë autokolona ndodhej në vendin më të përshtatshëm për ta goditur, maqinat e para kaluan në krah të majtë të çetës, kurse të tjerat ndodheshin pas njëra — tjetrës në intervale të rregullta dhe zgjateshin deri tej krahut të djathtë.

«Pam-pam, u dëgjuan shpejt edhe disa të shtëna të rralla, pastaj ja filluam të gjithë. Shokët i kishin armiqtë si në pëllëmbë të dorës, prandaj shënjonin mbi ta e hiqnin gishtin. Për disa minuta gjermanët, të gjetur në befasi dhe të ndodhur në një vend të papërshtatshëm për ta, u hutuan dhe bërtnisnin e çirreshin, pa na u përgjigjur me zjarr. Por shpejt, pasi kaloi tronditja e parë, ata e muarën veten, plumbat e tyre na vërshellenin djathtas e majtas, ose përplaseshin për gurësh e lëshonin një tym të bardhë. U ndez një luftë e egër.

Aty para meje, në mes të rrugës, kishte ndaluar një maqinë, nën të cilën qenë futur një grup ushtarësh, që po na qëllonin. Ata na dëmtonin më tepër, pasi qenë më afër nga të tjerët, dhe shokët tanë nuk po shikonin dot, kështu që nuk u ruheshin plumbave të tyre.

Vendosa të hidhja dy granadat që kisha, nën maqinë. U nisa duke u zvarrisur përpara, përmes gurëve, për t'u afruar.

— Ku shkon? — dëgjova që nga pas zërin e Bilalit, kur unë kisha bërë disa metra.

— Të hedh granadat kundër atyre që janë nën maqinë!

— Është vënd i zhveshur, do të të vrasin!

Nuk ju përgjegja. Vazhdova të zvarrisem poshtë. Gjermanët më diktuan dhe po më qëllonin me zjarr të dendur. Plumbat e tyre binin djathtas e majtas në tokë e në gurë me një vërshëllimë të thatë, por megjithatë unë vazhdoja të afrohesha duke u zvarrisur e hedhur nga njeri gur në tjetrin derisa të mbërrija aq larg sa të ma hante krahu që granadat e hedhura nga unë të arrinin deri te maqina në rrugë. U ndala. Mora një të granadë, i hoqa sigurecën dhe po bëhesha gati ta hidhja, kur për çudi, shoh se që nga e majta ime një granadë fluturoi në ajër dhe ra në mes të maqinës ku ishin futur gjermanët. Tymi dhe flaka u përziën me ulërimën e armiqve të shpartalluar. Pa humbur kohë, edhe unë e hodha granadën mbi një grup gjermanësh që kishin zënë pozicione anës rrugës nën xhade dhe u ktheva për të parë kush qëlloi para meje. Shoh Bilalin që qe shtrirë barkaz, aty afër e po qëllonte me automatik. Më erdhi inat me të, po s'pata kohë t'i flisja.

— Para, partizanë! — u dëgjua zëri i komandantit të çetës.

Të gjithë u hodhën në sulm duke qëlluar me pushkë e automatikë e duke hedhur granada. Bilalin e kisha gjithmonë në krah. Unë vrapoja poshtë, ai po ashtu vraponte herë para meje e herë anash. «Pse m'u ngjit ky sot pas, mendova me vete, ky s'më ka ndertur ndonjëherë mbi kokë?»

Gjatë sulmit vala e një predhe gjermane që plasi aty afër, më rrëzoi në tokë.

— Çou, përpara në sulm! — dëgjova zërin e Bilalit. U çova dhe përmes tymit, po ecja me shokët.

U përleshëm keq me armiqtë, por më në fund ata u tërhoqën të çrregullt, duke vrapuar sa mundnin. Vetëm plumbat çoku i arrinin në të rrallë e i rrëzonin në tokë.

Pasi u shuan të shtënat e pushkëve, u mblodhëm në rrugë e pasi grumbulluam materialin, po shikonim maqinat e djegura dhe kufomat e të vrarëve. Pas pak u mësua se në atë luftim ishin plagosur dy nga shokët tanë dhe që vvarë një. Të gjithë u hidhëruam pa masë për vdekjen e shokut dhe fitorja na u errësua menjëherë. Aty ku ishim ne prunë tetë robër gjermanë, të cilët të shqyer e të grisur po qëndronin në rresht kokëulur e të zverdhur në fytyrë sikur të kishin dalë nga varri.

— Ti vrasim këta qenër, — foli ashpër, me zë të vendosur një partizan.

Bilali m'u afrua mua.

— Si mendon ti, shoku Qazim, për robërit? — më tha me zë të qetë e i dëshpëruar për vras-

jen e shokut dhe më shikoi drejt në sy, sikur nga mendimi im të varej shumë.

— Duhet të mësojmë se të ç'shtrese janë. Janë të varfër, apo të pasur, i thashë, duke kujtuar ato që ai vetë më kishte thënë dikur.

Bilali, me gjithë brengën që kish në zemër, vuri pak buzën në gaz dhe më tha:

— Ata janë robër, shoku Qazim, dhe ne nuk duhet t'i vrasim robërit, të çfarëdo shtrese të jenë.

— Pastaj më foli gjërë e gjatë për këtë çështje...

Çeta ishte mbledhur në anë të një lumi, ujët e të cilit, pasi vinte që lart nga malet me shpejtësi, përplasej gjatë rrugës së tij me gurët që takonte në shtrat, shkumëzonte dhe prapë derdhej poshtë. Ne ishim ulur nën ca rrapa të rinj e po pastronim armët. Aty pranë meje erdhi e u ul këmbëkryq Bilali. Ai me ngadalë zbërtheu automatikun e tij dhe filloi ta pastronte. Mua, ç'është e drejta, nuk më pëlqeu, që ai erdhi dhe u ngul aty afër, sepse e dija që, pa më pyetur për ndonjë gjë e pa më bërë, në fund të bisedës ndonjë konferencë të vogël, nuk mund të shkëputesha prej tij. Veçanërisht e kisha vënë re këtë, ato dy muajt e fundit, që ai bisedonte, herë pas here me mua, dhe, pothuaj gjithmonë, me marifet, shpinte fjalën në ato çështje që unë i kuptoja pak. Edhe tashti ai, po ashtu veproi. Duke kthyer grykën e automatikut nga dielli, mbylli njerin sy e po e shikonte përmes fyellit në ishte pastruar mirë, pastaj papritur m'u drejtua mua:

— Shoku Qazim, a e di ti ç'është diktatura e proletariatit?

Nuk ju përgjegja menjëherë, qëndrova ashtu i menduar për disa sekonda me sytë e ngulur në

grykën e pushkës, dhe mundohesha të kujtoja ndonjë gjë nga ato që na kishin thënë për diktaturën e proletariatit në punën politike.

— Folë, e di apo jo?

— Nuk e di mirë.

— Por çfarë di?

— Di vetëm atë, që kur proletariati ka fuqinë në dorë, i shtyp armiqtë e punëtorëve e të fshatarëve, ashtu si edhe borgjezia kur ka fuqinë në dorë i shtyp punëtorët e fshatarët.

— Po më gjatë a di ta spjegosh?

— Jo.

Ai këtë radhë nuk u zemërua, siç bënte nganjëherë, por bëri buzën në gaz e nuk foli më. Ndërsa më vonë, kur gjetëm kohë të lirë, më mori në një anë e më tha:

— Ti atë çështjen e diktaturës së proletariatit nuk e ke shumë të qartë dhe filloi të më tregonte me hollësi e durim shumë gjëra që unë i dëgjoja për herë të parë.

— E kuptove? — më pyeti më në fund.

— E kuptova, po ç'm'i thua mua të gjitha këto, se mos do të bëhem komisar.

— Të duhen pa t'i mësojmë — më tha ai dhe qeshi, pastaj më pyeti prapë:

— A ke pronë private?

— Çfarë? — e pyeta unë, që nuk e kuptova përse po më pyeste.

— Pasuri a ke?

— Domosdo, kam.

— Çfarë?

— Nja njëzet dhen, një ka dhe katër dynym tokë.

— A të dhimbsen?

— Si s'më dhimbsen, të mos i doja, i kisha therur, ose i kisha lënë në pyll t'i hante ujku, — i thashë dhe qesha.

— Jo nuk ta kisha aty fjalën, tha ai, po ja për shëmbull për interesin e përbashkët a i jep ti bagëtinë dhe arën tënde?

— A do të ketë ndonjë partizan që sot po jep jetën, të mos japë dhentë për interesin e përbashkët? — i thashë unë me seriozitet dhe pak i mër-zitur, sepse nuk e kuptova se ku e kish qëllimin ai me këtë pyetje.

— Këtë e ke plotësisht të drejtë, por unë, prapë nuk e pata aty fjalën, nejtse do të bisedojmë më gjatë për këtë çështje, — më tha ai dhe filloi të më spjegonte gjëra mbi pronën private, që unë as i merrja me mend më parë...

Gjermanët kishin zënë një fshat, dhe, pasi u vunë zjarrin shumicës së shtëpive, po masakronin plaka e fëmijë që gjenin aty. Ne u nisëm për të sulmuar armikun. Që nga larg dukeshin shtëllungat e tymit që ngriheshin lart dhe dëgjoheshin britmat dhe ulërimat që vinin që nga fshati.

— Më shpejt, shokë! — urdhëroi komandanti.

Kur mbërritëm mbi fshat, të ndarë në skuadra, pa u vonuar ja filluam luftës me rojet gjermane që takuam të parat, pastaj me pushkë e bomba çamë përpara për në pozicionet e armikut. Gjermanët që e kishin paraparë një sulm të tillë, u grumbulluan në një kodër në fund të fshatit, dhe që aty na qëllonin me një zjarr të dendur mitralozash, pushkësh e mortajash, saqë nuk shikoje gjë tjetër, veç tymit e flakës.

— Para, partizanë! — thirri Bilali, që po sulmonte në krahun tim. Ai edhe aty në sulm, herë

pas here, vetëtimthi, hidhte shikimin mbi mua dhe prapë sulmonte përpara.

Po i ngjiteshim kodrës, afër njëri-tjetrit. Ecnim përmes ca sfakave të dendura, degët e fletët e të cilave flakeshin në tokë prej plumbave të armikut. Në këtë e sipër mua më goditi një plumb mbi vetull të djathtë, po shkarazi. Më mbuloi gjaku, se është e vërtetë ajo që thonë se nga plaga e vogël del gjak më shumë. Bilali më pa ashtu të mbuluar me gjak dhe briti i dëshpëruar:

— U plagose në ballë! — më tha dhe më kapri për krahu. Unë po qëndroja në këmbë pa e ndjerë shumë dhimbjen e plagës; vetëm më digjte pak.

— S'kam gjë, ndonjë cifël guri do të më ketë gërvishur.

Ai më uli në tokë, ma fshiu gjakun dhe ma pa plagën me kujdes.

— Jo, s'është cifël guri, është plumb gjermani, por të ka marrë anash — më tha dhe shpejt e shpejt ma lidhi kokën me shaminë e tij. — Tashti ulu këtu pas këtij shkëmbi e mos luaj që këndeje sa të kthehemi ne.

Bilali u nis lart. Unë u çoja dhe mora rrugën pas tij. Ai më pa dhe tundi kokën, po nuk foli. Kur po i afroheshim majës së kodrës, bombat tona të dorës po pëlçisnin midis gjermanëve, dhe bombat e tyre fluturonin midis partizanëve. Krismat e automatikëve, pushkëve dhe mitralozave u bënë më të dendura. Plumbat vërshëllenin nga të gjitha anët, era e etrolitit që delte nga plasja e bombave të zinte frymën.

— Para, partizanë! — dëgjova midis tymit dhe flakës zërin e Bilalit. Ai ecte anash meje, jo shumë larg, duke qëlluar me automatik e duke hedhur

granadat mbi armiqtë. Në një çast ai u rrëzua. U çua prapë dhe, pasi hodhi para dy-tre hapa të çrregullt, prapë u rrëzua në shpinë. Vajta shpejt pranë tij dhe pashë se, që nga mezi i ballit i kullonte gjak, një gjak i kuq flakë, i cili rrëshqiste përmes faqes e binte në tokë. E kapa dhe e ngrita nga shpatullat.

— Bilal! Bilal!

Ai nuk më foli, hapi sytë e tij të zez dhe më shikoi ashtu si nëpër mjegull. Plaga e tij ishte e madhe, këtë unë e kuptova. Ai po venitej, jetonte minutat e fundit.

— Shoku Bilal! — i thirra prapë, po më fort, dhe lotët nuk m'u mbajtën.

Ai më kapi dorën dhe ma shtrëngoi, dhe me zë të mekët, sa mezi shqiptonte fjalët më tha:

— Mos qaj, shoku Qazim, komunistët nuk qajnë! — Me mundim nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës një blok të vogël shënimesh e ma dha mua. Këtë unë ja dorëzova komisarit.

Ai vdiq.

Ne i mundëm gjermanët. Pas luftimit, me pikëllim në zemër, çeta e varrosi Bilalin dhe u nisëm për në aksione të tjera.

— Shoku Qazim, hajde pak me mua! — më tha zëvendëskomisari i çetës.

U nisëm bashkë pa shkëmbyer asnjë fjalë rru-gës, e shkuam në një shtëpi të ulët përdhese të një fshatari, në mes të ca kallamave. Lufta që bëhej jo shumë larg nga ne, dëgjohej aty fare mirë. Ne me mend, sipas krismave të armëve e përcaktanim, nëse qëllonin gjermanët me automatikët dhe «Sharrëzat» e tyre, apo qëllonin partizanët me pu-

shkë dhe breshëritë e shkurtëra. Aty brenda gjetëm edhe tre shokë të tjerë nga të çetës, komisarin, komandantin dhe mitralierin e skuadrës së dytë, një partizan trim e fjalëpak, të cilin të gjithë shokët e donin si trim pò edhe druheshin se ai edhe për gjënë më të vogël të kritikonte.

Pasi u ulëm, ata nxorën nga një blok shënimesh e po prisnin në heshtje. Unë nuk po e merrja dot me mend pse më thirrën. Ç'kam bërë? Ç'është kjo mbledhje me pesë veta?

— Shokë, — na preu fillin e mendimeve zëvendëskomisari. — Sot kemi mbledhjen e celulës së partisë... Çështjen e parë të rendit të ditës kemi pranimet në parti. Çështjen e dytë... Dakord jeni që të zhvillojmë mbledhjen me këtë rend dite?

Të tre të tjerët dhe ai vetë çuan duart lart në shenjë aprovimi. Atëhere kur pashë ata, e çova edhe unë.

— Ti, Qazim, mos voto. Ti s'ke të drejtë, — më tha komisar. Të tjerët vunë buzën në gaz. Unë ula dorën i turpëruar dhe s'dija ç'të bëja, mbeta ngushtë.

— Sipas rekomandimit të shokut Bilal, duhet të shqyrtojmë pranimin në parti të shokut Qazim, — vazhdoi zëvendëskomisari.

Kjo, mua më habiti më shumë. Bilali kish rreth një muaj që ishte vvarë!

Në fillim zëvendëskomisari foli gjerë e gjatë mbi historinë e Partisë Komuniste Shqiptare, mbi programin e saj dhe mbi detyrat dhe të drejtat e anëtarit të partisë. Pastaj ai u foli shokëve mbi origjinën time dhe për cilësitë personale të miat. Për çudinë time, ai gjatë fjalës, shumë gjëra thosh nga ato që më kishte pyetur e spjeguar Bilali në bise-

dat e ndryshme. Folën edhe të tjerët, të cilët herë më lavdëruan e herë më kritikuan, me të drejtë. Kur qe diskutuar me hollësi dhe kur shokët mua-rën edhe mendimin tim, zëvendëskomisari i pyeti:

— Kush është dakort që shoku Qazim të pranohet në parti?

Të gjithë ngritën duart, vetëm unë jo.

— Tashti ti, shoku Qazim, je anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare, — më tha zëvendëskomisari dhe më uroi duke më shtrënguar dorën e duke më përqaftuar. Kështu bënë edhe shokët e tjerë.

Pasi u diskutua edhe pika tjetër e rendit të ditës, mbledhja mbaroi. Shokët ikën më parë, kurse zëvendëskomisari dhe unë mbetëm pas. Ai më hodhi dorën në sup e po ecnim.

— Shoku zëvendëskomisar, i thashë, unë një gjë nuk e kuptoj.

— Çfarë?

— Shoku Bilal u vra para një muaji...

— A, si të rekomandoi ty?

— Po.

— Për të të përgatitur ty për t'u pranuar komunist, vazhdimisht punoi gjithë celula. Po shoku Bilal qe ngarkuar posaçërisht të të mbante afër, të njihej me ty më mirë dhe të të ndihmonte në zhdukjen e të metave dhe ngritjen ideologjike. Ti e kupton, partizanë trima ka shumë, por që të gjithë nuk i kanë cilësitë për të qenë komunistë. Prandaj shoku Bilal herë pas here bisedonte me ty dhe rezultatet, në çdo mbledhje që bëhej ja raportonte celulës së partisë.

Pastaj ai nxori një bllok nga xhepi e ma dha mua.

— Na lexoje, aty ka edhe diçka për ty, që tashti s'është më sekret.

— E mora, e njoha menjëherë, qe bloku i Bilalit, të cilin ai para vdekjes ma kishte dhënë mua. Kur u ndava me zëvendëskomisarin, u ula vetëm dhe fillova ta shfletoj...

«Sot bisedova me shokun Qazim mbi qëllimin e Luftës nacionalçlirimtare, mbi detyrat tona gjatë luftës dhe mbi pushtetin që do të ngrejme. Akoma ka paqartësira. Kur ja shpjegova, i kuptoi drejt. Mund të punohet me të.»

«Bisedova me shokun Qazim për klasat dhe luftën e klasave. Nuk ka kuptim të plotë për këtë çështje. Duhet punuar akoma me të...»

«Gjatë një luftimi qëndrova afër me shokun Qazim, dhe vrojtova me kujdes veprimet e tij. Është trim.»

«Sot bisedova me shokun Qazim mbi diktaturën e proletariatit.»

Aty kish, pothuaj, gjithë bisedat që ai kishte pasur me mua. Më në fund, në një fletë shënonte:

«Propozoj që shoku Qazim të pranohet anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare.»

Këto fletë, të këputura nga bloku i Bilalit, unë i ruaj edhe sot bashkë me taserën e anëtarit të partisë.

MIQTË

Kolona e ushtarëve, që vazhdonte marshimin në rrugën që kish kaluar një nga batalionet më të përmendura partizane, mbërriti në krye të fshatit. Ishte mesi i dimrit. Qilimi i bardhë prej dëbore me trashësi pothuaj një metër kishte mbuluar gjithshka përreth. Vetëm nga oxhaqet e shtëpive dilte një tym i hollë, i errët që ngjitej lart në qiell. Ushtarët u ndalën. Para tyre doli një oficer, në tëmthas e të cilit, shquheshin thinjat. Ai qëndroi e hodhi shikimin tutje mbi dy male të lartë që qëndronin karshi njëri-tjetrit, pastaj më afër, në disa kodra të ulëta që i dalloje në atë bardhësi vetëm nga konturet e tyre që projektoheshin në shpatet e maleve. Më në fund oficeri përqëndroi shikimin e tij mbi shtëpitë e fshatit; ai i hetonte ato një nga një me radhë dhe ashtu i thelluar në mendime mbeti disa çaste pa vënë re të tjerët që e rrethonin.

— Ja, shokë, pikërisht këtu kemi qëndruar edhe atëhere, gjatë kalimit për në këto zona. Ky fshat quhet Guras. Borë, atëhere kishte sa tashti, në mos më tepër. Armiku ishte vendosur në grykat poshtë dhe në kodrat tutje. — tha oficeri dhe tregoi me dorë. — Më kujtohet se atë ditë që erdhëm

në këtë fshat, ishim të lodhur dhe shumë të uritur, megjithatë ecnim në ndjekje të armikut... Kam njohur, nga ky fshat një partizan trim, i cili na u vra në luftimet që u zhvilluan disa orë larg prej këtej...

— Ushtarët! Ushtarët! Urra!... — U dëgjuan në këtë çast të thirrurat e forta të fëmijëve të shkollës, të cilët sa muarën vesh për ardhjen e ushtarëve, dualën me vrap në oborr dhe filluan të hidheshin të gëzuar mbi borë.

Oficeri e ndërpreu tregimin dhe u kthye nga fëmijët. Padashur, ai ndjeu një tronditje. «Tamam ajo tablo, mendoj ai, fëmijët na priten të parët edhe atëhere, veçse ata nuk ishin në shkollë, por rrugëve, dhe nuk thërrisnin «ushtarët», por «partizanët». Pas zhurmës së fëmijëve aty në mes të fshatit u grumbulluan disa burra e gra. Ushtarët në njësh kolonë, duke kënduar këngë partizane dhe revolucionare, zbritën në fshat aty ku qe grumbulluar populli.

— Në radhë të parë do të shkojmë të gjithë bashkë në varret e dëshmorëve të fshatit, — u tha oficeri me thinja shokëve të organizatës së partisë dhe të këshillit të fshatit. Pastaj në grupe do të vemë vizita nëpër familjet e tyre.

Kështu u bë. Pasi dualëm nga varrezat e dëshmorëve, ushtarët të ndarë në grupe dhe të shoqëruar nga një shok i këshillit, u shpërndanë në drejtime të ndryshme. Oficeri ecte në krye të një grupi. Pas tij vinin ushtarët dhe shoku i këshillit, i cili mendonte: «Ku vete ky kështu? Ku e di ky shtëpinë e dëshmorit?» Kurse oficeri mendonte: «A jeton vallë nëna e partizanit Dule?» Dhe ju kujtua dita kur kishte ardhur në shtëpinë e nënës së

partizanit dhe kishte prurë me vete lajmin e kobshëm dhe dyfekun e shokut të vvarë. Mendimet e oficerit i ndërpreu pyetja e shokt të këshillit:

— Për ku je drejtuar, o shok? Andej s'ka familje dëshmori.

— Ka, — ju përgjegj oficeri dhe vazhdoi rrugën me hap të shpejtë, saqë ata që vinin pas tij, mezi po e arrinin.

— Nuk ka, mos e ke ngatërruar. — i tha prapë shoku i këshillit.

Oficeri ngadalësoi hapin, pastaj ndaloi fare, dhe, pasi u mendua pak, ju drejtua shokut të këshillit:

— A nuk është ajo shtëpia atje, dhe tregoi me dorë një shtëpi të vogël, ndërtuar në krye të një are, — shtëpia e dëshmorit Dule? A nuk banon atje nëna e tij?

Shoku i këshillit shikoi shtëpinë që tregoi oficeri, kurse ky, duke pritur përgjigjen, shikonte që nga koka gjer te këmbët shokun e këshillit, i cili në atë kohë kur që vvarë partizani shumë-shumë duhej të kish qenë akoma me fustan.

— Jo, nëna e tij nuk banon atje. Domethënë, — tha shoku i këshillit i ngatërruar — ajo ka vdekur. Në atë shtëpi tashti banojnë arësimitarët.

Oficeri qëndroi pa folur dhe po mendohej.

— Pavarësisht shokë, shkojmë te shtëpia e dëshmorit Dule. Do t'u tregojmë edhe arësimitarëve për atë partizan trim.

U nisën për atje.

Xha Aqifi kishte marrë vesh qysh më parë se në fshat do të vinin ushtarë, të cilët ndiqnin atë rrugë që kish ndjekur një batalion partizan gjatë Luftës nacionalçlirimtare. Ai edhe i dëgjoi këngët e tyre që jashtë fshatit, mirëpo nuk mund të ngrihej dot nga shtrati për t'i pritur aty ku i pritën të tjerët, sepse kish kohë që qe i sëmurë. Ashtu i dobët, shtrirë dëgjonte këngët partizane. Këngët partizane...! «Po, ja kështu këndonin edhe atëhere... Ja këtë këngë e këndonin ata djemtë sa herë që vinin në fshatin tonë... Ajo vajza me flokët e prerë shkurt dhe me gjerdanin hedhur krahaqafë e me pushkën në dorë ja merrte e para... Edhe të plagosurit këndonin këngë partizane...» Me sytë e mbyllur përgjysëm xha Aqifi u zhyt në të kaluarën. Sillte ndër mend luftimet që kishin zhvilluar partizanët në ato anë dhe ku, shumë herë me forcat territoriale kish marrë pjesë edhe ai, sepse pushka e tij gjatë gjithë luftës kishte qenë përkrah partizanëve, kurse shtëpia e tij kishte qenë vatër e ngrohtë për luftëtarët e lirisë. Fillin e mendimeve ja preu e bija që u kthye nga puna. Ajo hodhi një krah dru, që kishte prurë, prapa sofasë së oborrit dhe u fut brenda duke fërkuar duart e skuqura nga të ftohtët.

— Qysh e ndjen veten? — i tha ajo dhe ju afrua te shtrati.

— Ja, ashtu siç kam qenë, ju përgjegj ai.

E bija pas pak filloi të merrej me punë shtëpie.

— Bëna ndonjë gjë për darkë se do të na vinë miq, — i tha ai se bijës.

— Kush na vjen? — pyeti ajo.

— Do të na vijnë partizanë.

— Cilët partizanë? Ku ka sot partizanë? — e pyeti e bija e habitur.

— Ja moj, ata ushtarët që kalojnë në rrugën e partizanëve.

— Po vallë do të na bien neve?

— Qysh s'do të na bien? Po ku do t'i ndajnë për të fjetur, pse, jashtë do t'i lënë, në borë?

E bija ja filloi punës për përgatitjen e darkës.

— Pa shih mos na marrësh ndonjë pulë te gjitonët dhe ua paguajmë. Mundohu ti kënaqësh ushtarët.

— Mirë — ju përgjegj ajo dhe vazhdonte të merrrej me punë, ndërsa fëmijët e saj që ishin mbledhur qark rreth vatrës, në dhomën tjetër, filluan të grindeshin me zë të lartë.

— Unë jam ushtar, — thoshte një djalë rreth pesë vjeç, i plluckër në fytyrë.

— Unë jam partizan, — përsëriste tjetri, rreth katër vjeç.

— Ti s'mund të jesh partizan se s'ke mustaqe, — ju hodh i pari. — I ke parë partizanët në fotografi? Ata janë me mustaqe.

— Po edhe ti s'je ushtar se ti s'ke as kapele me yll e as dyfek.

Fëmijët grindeshin. Xha Aqifi i dëgjoji dhe nuk i erdhi mirë kur fëmijët i përfytyruan partizanët me mustaqe. «Sa kishte midis tyre pa vënë brisk në faqe. — mendonte ai.

* * *

Në mbrëmje, ushtarët, pasi kënduan me të rinjtë dhe të rejtat e fshatit dhe pasi bënë një mbledhje të përbashkët, ku biseduan për probleme të

ndryshme, u ndanë nga dy-tre veta nëpër shtëpitë e vendit për të kaluar natën.

Tashti kënga nuk dëgjohej më.

Xha Aqifi mbajti vesh mirë për disa minuta. «Pse e ndaluan këngën», mendoi me vete. Po kur hodhi sytë nga dritarja dhe pa mugëtirën e mbrëmjes, e kuptoi që ishte errur dhe ushtarët tani po i ndanin nëpër baza. «Ja tashti do të vinë te ne» pëshpëriti dhe u çua ngadalë; ndezi llambën me vajguri dhe e vuri në prevaz të oxhakut.

Vajti vonë. Edhe njerëzit që kalonin rrugëve, duke biseduar me zë të lartë, nuk dëgjoheshin më. «Pse s'po vinë akoma»? — mendonte xha Aqifi dhe veshët i mbante ngritur mos dëgjonte hapa në oborr. Minutat kalonin. «Pse u vonuan kaq»? Duke qenë në pritje të ushtareve, atij i kujtohej se edhe atëhere në kohën e luftës ndodhte që ndonjë grup të vinte vonë në bazë, për shembull kur disa prej tyre, pasi shpërndaheshin shokët, bënin mbledhje, ose kur në bazë qenë caktuar shokët që ishin roje në orët e para të mbrëmjes. «Sidoqoftë duhet të na kishin lajmëruar» — mendonte me vete dhe u çua e po lëvizte nëpër shtëpi duke u marrë me punë të parëndësishme.

Kaloi akoma kohë. U pa e qartë se në atë orë nuk mund të prisje më të vinin miqtë.

— U bë natë. Si duket neve nuk na kanë caktuar — i tha e bija, në zërin e së cilës dallohej dëshpërimi.

Xha Aqifi nuk ju përgjegj. Veshi këpucët, mori bastunin që prapa derës dhe doli.

— Ku vete tashti në këtë kohë? — e pyeti ajo, por i ati u nis dhe ajo dëgjoi vetëm një të kollur të mbytur që nga oborri.

— Babagjysh, të vij dhe unë te partizanët? —
i foli që nga praku i derës, djali që e quante ve-
ten partizan.

Xha Aqifi, kur dëgjoi fëmijën, ktheu kokën
pas, djali kishte dalë i zbathur dhe po ecte mbi
borën e trashë, për ta arritur atë.

— Ikkë brenda, tashi do kthehem, — i tha ai
fëmijës dhe e përcolli për ta kthyer në shtëpi.

Ai u nis për në zyrrat e këshillit. Bora e tra-
shë dhe e ngrirë kërciste nën këmbët e tij. Ecte me
kokë të ulur, hapat i hidhte shpejt. «Pse s'më dër-
guan mua ushtarë?» — mendonte. Atëhere që s'ki-
sha as qull thekre për të ngrënë, i ndanin parti-
zanët në të gjithë shtëpitë, tashti që kam bukë të
mbushim barkun tonë e të atyre, te ca çojnë nga
tre-katër, kurse te ca, si unë, s'bien fare. Janë mas-
karenj!»! — shfryu xha Aqifi.

Duke menduar kështu e duke shfryrë, nganjë-
herë edhe me zë të lartë mbërriti te zyra e këshillit.
Vetëm kur u ndodh ballë për ballë me derën, ai e pa
që atje s'kish as drita e as një njeri dhe dera që e
mbyllur. «Phu!» pështyu mbi borë dhe u nis për
në shtëpinë e kryetarit të këshillit të fshatit. Të
ftohtët ishte i madh, aqsa as qentë nuk guxonin të
dilnin prej kasolleve të tyre me kashtë. Po xha
Aqifi nuk e ndjente të ftohtin, ai duke shtypur si
me inat, me opingat e tij, borën e ngrirë, po ec-
te me kokë të ulur. Derës së kryetarit të këshillit
i ra dy tri herë me dorezën e bastunit. Pas pak
ajo u hap.

— Hajde, xha Aqif, hajde brenda — i tha krye-
tari i këshillit, një burrë rreth të tridhjetave.

Xha Aqifi hodhi sytë në dhomën e miqve
ku qenë ndezur llambat dhe dukeshin mirë dy

ushtarë dhe një oficer i ri të cilët, bashkë me njerëzit e shtëpisë, qenë ulur rreth sofrës ku qenë shtruar rakia e mezetë.

— Të faleminderit, nuk erdha për të nderitur. — ju përgjegj i vrejtur xha Aqifi. — Erdha të di pse nuk më dërguat edhe mua ushtarë, apo nuk i nxe shtëpia ime.

Kryetari i këshillit nuk i foli menjëherë, ndërsa me vete mendoi: «Je një çikë ngushtë nga ekonomia, more i bardhë». Por këtë nuk ja tha plakut, sepse e dinte që ai do të merrte zjarr më tepër. Atij ju përgjegj ndryshe:

— Po këtë radhë, more xha Aqif, nuk kishte aq shumë ushtarë. Për këtë je zemëruar ti? — e pyeti ai me buzëqeshje. Herë tjetër do të dërgojmë ty, të parit. Tashi hajde ulu të bëjmë muhabet me këta shokët.

— Dëgjo, djalë! Ti je i vogël të më gënjesh mua!

Vetullat e xha Aqifit pothuajse u bashkuan, kurse rrudhat vertikale të ballit u tendosën si tela. — Ti je kryetar i pushtetit, dhe unë si plak që jam do të këshilloj një gjë: ti po deshe mbaje në vesh, po deshe hidhe poshtë, bën si të duash: Kur të vijnë ushtarë në fshat, ti më përpara do t'i dërgoç në ato shtëpi, që prisnin e përcillnin partizanë edhe ahëre kur s'kishim as qull elbi për të ngrënë e jo bukë misri. Në mos i di ti ato shtëpi, se ahëre ke qenë akoma me fustan, t'i dëftoj unë.

Kryetari i këshillit uli kokën, ai e kuptoi se xha Aqifin e kishin zemëruar shumë. E shoqja dhe një fëmijë i vogël, i cili qe kapur pas fustanit të gruas, qëndronin në korridor dhe shikonin të ndroj-

tur fytyrën e ngrysur të plakut. Dy ushtarët dhe oficeri i ri po dëgjonin me sytë e ngulur nga dera.

— Sonte u bë kjo, xha Aqif, — i tha shkurt kryetari i këshillit.

— Meqë u bë keq, rregulloje, — ju përgjegj tjetri.

— S'kam sesi, është vonë. S'mundem t'i ngre njerëzit nga sofra e tjetrit.

— Mirë, — i tha plaku, pasi bëri një hap në drejtim të dhomës ku qenë shtruar ushtarët dhe oficeri. E dini ju djem ku ndodhet komandanti juaj? — i pyeti ata.

— Ç'e do? — e pyeti shpejt e i habitur kryetari i këshillit.

— Kam punë me të, — ju përgjegj ai, pa i hequr sytë nga ushtarët, prej të cilëve priste përgjigje.

Oficeri i ri u çua në këmbë, nxori një blok nga xhepi dhe pasi e hapi dhe lexoi diçka në të, ju drejtua plakut:

— Komandanti është në shtëpinë e...

— Mbeçi mirë, — u tha plaku ushtarëve, nuses së kryetarit të këshillit dhe u largua.

Rruga për në shtëpinë e... ishte pak e gjatë. Shtëpia ishte në krye të fshatit. Plaku u nis për atje. Dëbora e ngrirë kërciste me një zhurmë monotone gërr-gërr. «Do t'i bie shkurt» — mendoi xha Aqifi dhe ju ngjiti kodrës drejt, duke lënë rrugën djathtas. Po kjo i doli më keq. Ai hoqi shumë duke kaluar ledhe e hendeqe e duke shkarë në borën e bërë si pllakë guri. Duke ecur i erdhi në mend një mbrëmje në vitin dyzet e tre... Në shtëpinë e tij këshilli kishte caktuar tre partizanë. Atë mbrëmje e kishte ndjerë veten me ngushtë se kurrë. Nuk

kishte asgjë për të ngrënë, as për fëmijët e tij, e jo me të ngopte dhe barkun e uritur të partizanëve. Po ç'të bënte, t'u thoshte që s'kish me se t'i ushqente, e t'i kthente prapë? Jo, ky do të qe turp i madh. Xha Aqifi pasi i futi partizanët brenda e i rregulloi të ngroheshin rreth zjarrit, mori një trastë, e hodhi në sup dhe shkoi te millonai i fshatit: «Aman, i tha atij, dy okë miell çfarëdo që të jetë, thekër a elb, a shejtan, veç mos më kthe bosh». Mullixhiu e kuptoi se Aqifi kishte nevojë, po ç'ti bënte ai kur nuk kishte asnjë grusht për be, e jo dy okë. Megjithatë pa folur mori një fshesë të vogël dhe filloi të fshinte rrëzët rreth gurit të mullirit dhe nga kjo mblodhi nja dy duar miell. Pastaj shkoi në të ndarën tjetër dhe që andej pruri një kalli misri të thatë. Të gjitha këto ja hodhi në trastë Aqifit. «Skam me se të të ndihmoj, i tha, veç shpirtin kam. Po deshe mblidh dhe ca hithëra, ka këtu në kopsht». Dhe Aqifi pasi mbushi trastën me fletë hithre, u kthye në shtëpi. «Ngreu, i tha së shoqes, vëre kusinë në zjarr e zieje» dhe e hodhi trastën e tij pas derës. E shoqja me ato që solli Aqifi bëri një tepsi të mirë të pjekur në saç sa s'kish ku të vinte më. Veç kësaj partizanëve u nxuarën dhe nga një tas me lëng goricash dhe çantat e tyre të nesërmen, kur u larguan, ua mbushën me mollë të egra...

Më në fund arriti dhe filloi të trokiste në derën e shtëpisë ku ishte komandanti.

— Hajde, xha Aqif. Nga na vjen kështu që je bërë tërë borë? — e pyeti i zoti i shtëpisë.

— Kam një hall tjetër — ju përgjegj xha Aqifi. — Dua komandantin e ushtrisë.

Oficeri me thinja, sa dëgjoji fjalët e fundit të

plakut, u çua dhe u përshëndosh me të duke i shtrënguar fort dorën.

— Ti je komandanti? — e pyeti plaku.

— Po, unë jam — ju përgjegj oficeri dhe po mendohej duke shikuar plakun në sy, që të gjente shakun e ardhjes së tij në atë orë të vonë dhe në atë kohë të keqe. «Mos ka pasur ndonjë keqkuptim me ndonjë ushtar. Mos vjen nga rrethi dhe mund t'i kenë dhënë ndonjë porosi? Mos ka diktuar ndonjë lëvizje të dyshimtë për të cilën duhen marrë masa? «Këto mendonte oficeri i vjetër, kur ja preu fillin e mendimeve plaku.

Xha Aqifi shkurt, por qartë ja tha komandantit se përse kishte ardhur.

— Pse kështu? — e pyeti oficeri të zotin e shtëpisë që ishte edhe anëtar i këshillit.

— S'pati për të dërguar në të gjitha shtëpitë, ju përgjegj ai, sepse nuk mund t'i thoshte në sy të plakut atë që kishte menduar këshilli kur ndau ushtarët: «Xha Aqifi është pak ngushtë nga gjendja».

— Mos më dredho mua! — i tha plaku të zotit të shtëpisë.

— Jo xha Aqif, mos e merr për të keq. Ç'ke ti, herë tjetër do të të caktojmë të parit.

— Për herë tjetër ju faleminderit. More mos kini menduar se s'kam mish të pjekur t'u vë përpara, e prandaj nuk më dërguat ushtarë? Po në qoftë se kini menduar këtë, ma thoni troç.

Oficeri nuk e zgjati më, mori kapelen, pastaj dha urdhër që prej dy shtëpive të tjera të hiqnin nga një ushtar dhe bashkë me ta, e me xha Aqifin në krye u nisën për në shtëpinë e tij.

B U K A

Pas luftimesh të përgjakshme me armikun, çeta partizane e detyruar nga gjendja e krijuar, ishte ngjitur lart në një mal të mbulur me dëborë. Çeta ishte e vogël, megjithatë ajo kishte zhvilluar luftime të pandërprera për disa ditë, duke i goditur fashistët, natën e ditën, atje dhe atëhere ku ata nuk e prisnin. Tashti çeta ishte tërhequr lart në mal e po priste rastin për t'u hedhur prapë në sulm. Kolonat armike që kishin ndërmarrë një operacion kundër lëvizjes nacionalçlirimtare në atë krahinë, po endeshin nëpër fshatra si bisha.

Ishte mesi i dimrit. Bora, si qilim i bardhë kishte mbuluar gjithshka përreth. Vetëm lisat e mëdhenj, bojë hiri, të zhveshur nga fletët, prishnin bardhësinë e vendit. Frynte një erë e ftohtë. Partizanët ishin mbledhur grupe-grupe rreth trungjeve të lisave për t'u mbrojtur nga era. Aty midis atyre lisave ishte një shpellë e vogël, e cila nuk merrte brenda më tepër se dhjetë-dymbëdhjetë. Por meqenëse shpella nuk e merrte të gjithë çetën, asnjë nuk pranonte të futej e të strehohej në të. Vetëm me këmbënguljen e të gjithë shokëve, u rregulluan.

atje dy partizanë të plagosur dhe një shoqe që i mjekonte ata.

Çeta, qëkur kishte filluar veprimet luftarake kundër armiqve, kishte vuajtur për ushqime, dhe me vështirësi kishte mundur të siguronte diçka për të ngrënë. Por tashti partizanët kishin më tepër se tri ditë pa futur asgjë në gojë. Intendenti i çetës bashkë me një partizan kishin ikur një ditë më parë për të gjetur bukë dhe akoma nuk ishin kthyer.

Të gjithë e ndjenin lodhjen dhe këputjen fizike që vinte nga mosngrënja, por mundoheshin të mos e tregonin. Komisari herë pas here bënte mbledhjen e gjithë çetës dhe zhvillonte punë politike, kritikë e autokritikë e të tjera. Jo rrallë që nga pas trungjeve të lisave dëgjoheshin këngë revolucionare. Megjithëse po kalonin çaste të vështira, nga shpella ku qenë shtrirë partizanët e plagosur, buçiti kënga e tyre e bashkuar me zërin e shoqes:

*Ato maja rripa — rripa se ç'gjëmojnë
ndizet lufta për liri e derdhet gjak.
Janë trimat partizanë që luftojnë,
janë bijtë e Shqipërisë që marrin hak...*

Një nga partizanët më të vjetër të çetës, në çastin kur dëgjoi këngën e shokëve të plagosur, u çua papritur në këmbë, ktheu kokën andej nga gryka e shpellës nga e cila derdheshin tingujt e këngës revolucionare, dhe po dëgjonte. Ai e dinte që të dy shokët ishin plagosur rëndë dhe shpëtimi i tyre nga vdekja, në ato kushte, që me pikëpyetje. Megjithatë, ata edhe tashti në majën e malit midis

dëborës dhe akullit, të uritur e me trup të copëtuar nga plagët e hapura prej plumbave të armikut, po këndonin këngët e revolucionit. Partizanit i rrëshqitën pikat e lotit përmes faqeve të zbeta dhe, për gudinë e të gjithë atyre shokëve që qenë aty me të, pasi u koll një herë mbyturazi, nxori kamën e tij dorezëargjëndë nga milli dhe me shpejtësi po hapte borën dy — tre metra larg trungut të lisit. Shtresa e dëborës ishte e trashë dhe e ngjeshur gur, por ai vazhdonte me majën e kamës ta thërmonte. Pas një copë here u zbulua dhe toka e zezë. Partizani pa humbur kohë mblidhte aty kokra lendesh e i fuste në gji.

— Ç'i do, ato s'hahen, — i tha një shok.

— Po të jenë të lisit të egër vërtet s'hahen, po të jenë të lisit të butë, hahen që ç'ke me të, vetëm se duhet të piquen në zjarr, — ju përgjegj ai dhe, pasi kishte mbledhur nja dy grushte lendesh, u nis për në shpellë. Aty shpejt e shpejt, me lejën e komandantit të çetës, shkrepri me hurorë dhe ndezi një zjarr të vogël, aq sa të mos bënte shumë tym e të diktohej. Pastaj, pasi poqi lendet, ua dha të plagosurve. Mirëpo ata ngulën këmbë dhe nuk pranuan t'i dallonin nga shokët, kështu që të gjithë partizanët muarën nga një kokërr. Përveç partizanit që i pregatiti, të gjithë të tjerët për herë të parë po e provonin shijen e lendeve të lisit.

Pas pak u kthye intendentit. Shokët e panë që larg. Ai vinte vetëm, me kokë të ulur dhe ecte ngadalë, sikur mendohej thellë për diçka. Ai vazhdonte të ngjitej lart malit, për në çetë. Ecte vërtet ngadalë, po shokëve, që e prisnin me kohë ardhjen e tij, u dukej sikur ai s'lëvizte fare nga vendi. Të gjithë që nga larg po e shikonin shokun që ecte

kokëulur dhe vetëm. Një ndjenjë shqetësuese i puthtoi shokët e çetës: «Pse ecën ashtu, ai e di që ne e presim që të na bjerë diçka? Po shoku që shkoi me të, ku është?»

Më në fund ai mbërriti midis çetës. Dukej i raskapitur e i këputur, fytyra që zbehur më shumë nga ç'ishte një ditë më parë.

— Vdekje fashizmit! — përshëndeti dhe, pa i shikuar shokët në sy, hoqi nga supi një trastë dhe e vuri me kujdes, sikur të kishte brenda në të të diçka që thyhej, midis partizanëve.

— Liri popullit! — ju përgjegjem.

— Po shoku ku është? — e pyeti komisari.

Ai nuk u përgjegj menjëherë. Ndejti një çast pa folur me sytë të ngulur në borën e bardhë, pastaj shikoi fytyrën e dobësuar të komisarit.

— Shoku u vra! — u përgjegj ai me zërin që i tradhëtoi ngashërimin e brendshëm. — Shoku u vra!... e përsëriti prapë pas pak dhe tregoi rrethanat në të cilat kishin rënë në përpjekje me armiqtë dhe mbi luftimin e zhvilluar.

Çeta u hidhërua për vrasjen e partizanit dhe me propozimin e komisarit e nderoi kujtimin e tij duke mbajtur një minutë zi e duke u betuar për të marrë hakun.

— Ne të dy mundëm të gjenim vetëm ato bukë, që janë aty në trastë. Merrini e i ndani.

— Ndaji vetë ti, — i tha komisari.

— Jo, unë do të nisem prapë për të gjetur bukë, — u përgjegj ai dhe, pa pritur përgjigjen e komisarit, me automatik në krah u nis poshtë.

— Prit, shok, merr edhe ti racionin tënd, — i thirri komandanti i çetës.

— Kam ngrënë — u përgjegj ai, me zë të ulët sa mezi u dëgjua dhe vazhdoi të ecte poshtë.

Por intendentit, ashtu si dhe shokët e çetës, nuk kishte ngrënë asgjë dhe ishte i uritur si shokët, e i lodhur nga rrugët e gjata.

Për të ndarë bukën u caktua një partizan. Ai mori trastën dhe që aty nxori dy bukë misri të pjekura në vatër, pastaj nxori dhe një kokër qepë e pak kripë, të lidhura në cepin e një shamie.

Shokët ishin mbledhur në formë rrethi. Një partizan, pasi shkoqi në pulqerin e dorës disa fletë të thata lisi, me një copë gazetë pleksi një cigare dhe po e thithte thellë.

«Si t'i ndaj? — mendonte partizani. — Qysh t'u jap të gjithëve barabar? Këta të gjithë janë njëlloj të uritur!»

Pasi u mendua pak, ai u çua dhe i ndjekur nga sytë e të gjithë atyre që ishin aty, shkoi më tutje dhe theu një degë lisi. Pastaj shpejt e shpejt, nga dega preu me thikë dhe përgatiti një furkë të cilën e nguli në mes të borës së ngrirë. Bëri dhe një shkop dhe e lidhi përpindikular në furkë. Në dy anët e shkopit vari dy shami dore si ballanca, dhe kështu aty për aty përgatiti, për çudinë e të gjithëve, një peshore pak a shumë më të saktë se syri e dora. Partizani u ul këmbëkryq mbi borë para «peshores». Të dy bukët i vuri nga e djathta e tij, mbi trastë, dhe nxori thikën e po i priste në copa të vogla. Megjithëse ai mundohej të mos i binin thërime, prapëseprapë kish raste që copat thërmoheshin.

Pasi i preu bukët, partizani hoqi nga gjerda-ni i tij një ballë fishekësh malihëri dhe e vuri

në njerën anë të ballancës, kurse në anën tjetër vendosi një copë bukë.

— Hajdeni shokë! — ju drejtua ai partizanëve. Hajdeni me radhë.

Asnjë nuk lëvizi nga vendi.

— Hajdeni, mos na vononi! — u tha ai prapë të gjithëve pa ju drejtuar ndonjërit.

Prapë asnjëri nuk lëvizi nga vendi. Të gjithë po shikonin shokun që po peshonte, dhe copat e bukës. Ata qenë të uritur, shumë të uritur. Fytyrat e të gjithëve ishin bërë limon, rrathët e syve u qenë bërë mavi, kurse sytë vetë sikur ishin futur më thellë. Ata kishin uri, por asnjëri nuk po afrohej të merrte atë copë bukë. Partizanëve nuk u largohej nga mendja shoku që u vra për të siguruar ato dy bukë misri!

— Shokë! — e theu heshtjen njëri nga partizanët — unë mendoj që këto bukë t'ua lëmë shokëve të plagosur dhe shoqeve të çetës. Si thoni ju?

— Mirë e ke!

— Dakord!

— Ashtu le të bëhet! — u dëgjuan zërat e të gjithë atyre që qenë aty.

Por shoqet kundërshtuan.

— Ç'është ky dallim për ne, shokë? Ne jemi partizane dhe nuk pranojmë të na dalloni nga shokët, — foli një nga ato.

Pas pak edhe që nga shpella u dëgjua një zë:

— Shoku komisar!

Të gjithë kthyen kokat andej. Aty te gryka e shpellës ishte çuar ndenjuri njeri nga shokët e plagosur, i cili e kish lidhur kokën me një shami që kish qenë e verdhë, por që tashti gjaku ja kishte ndryshuar ngjyrën.

— Shoku komisar, as ne nuk duam të na daltoni nga shokët. Neve ose na jepni sa të tjerëve, ose mos na jepni fare. Bukën le ta hani ju që do të niseni për luftë, — tha ai me zë të këputur, por të vendosur.

Komisari u mendua një çast. Edhe atë ashtu si shokët e tjerë, e kishte kapur një brengë e rëndë, por ai, pasi u mendua pak, urdhëroi:

— Shokë, të gjithë merrni pjesën e bukës!

Partizanët, një nga një afroheshin para shokut të tyre, dhe pa e shikuar atë në sy, zgjatnin dorën e merrnin copën e bukës, pastaj largoheshin disa hapa më tutje. Partizani që kish zëvendësuar intendentin, pasi peshonte bukën, e nxirte atë nga shambia, i hidhte sipër disa kokrra kripë dhe me kujdes ja vinte shokut në pëllëmbë të dorës. Ai i shikonte shokët në sy, me një keqardhje të brendshme që s'mund ta shprehte. Shokët kalonin me radhë. Ja, para tij një partizan i ri, sytë e të cilit, të lodhur ishin ngulur në copën e bukës që po peshohej. Pas tij erdhi një partizan i vjetër dhe më i moshuar nga të tjerët, të cilin e njihte e gjithë çeta që hante shumë. Ai u afrua dhe po priste. Partizani që ndante bukën, nxori nga gjerdani një ballë fishekë prej të cilit hoqi një fishek dhe e vuri mbi pesë fishekët e tjerë që ishin në ballancë, pastaj vuri bukën dhe pasi e peshoi, ja zgjati partizanit. Partizani, i cili e pa këtë, desh të largohej pa e marrë as pjesën që i takonte. Si duket i erdhi rëndë për këtë privilegj në këto rrethana të vështira për të gjithë shokët.

— Merre, një fishek më tepër, ta jap nga pjesa ime, — i tha partizani që ndante bukën.

Por, si veprimin e partizanit që ndante bukën,

ashtu dhe të partizanit që nuk e mori bukën, i vuri re edhe komisari i çetës, që qëndronte aty më këmbë i mbështetur në grykën e pushkës.

— Ktheu shok, merr bukën! — ju drejtua ai me zë të prerë partizanit që po largohej.

Ai u kthye, mori copën e bukës dhe u largua.

I erdhi radha edhe një shoqeje, një partizaneje të re. Ajo po qëndronte me sytë e ngulur mbi fytyrën e partizanit intendent. Atij, duke ja dhënë në dorë copën e bukës, i ra mbi borë një pjesë sa një gjysmë mëllëri. Shoqja, shpejt u ul, e mori dhe menjëherë e futi në gojë bashkë me kristalet e borës që i ishin ngjitur, dhe u largua tutje.

Duke ecur, asaj ju ngulën sytë mbi krodhën e bukës që mbante në dorë, ku ishte një pikë e kuqe sa një majë gjilpëre. U ndal dhe po e shikonte me kujdes: «Ç'të jetë? — mendonte me vete. Bojë? Jo! Gjak?» U kthye ashtu pa u vënë re afër partizanit që ndante bukën dhe po shikonte e përqëndruar trastën. Partizani, mblodhi ca thërrime që kishin rënë aty mbi borë, i ngjeshi në grusht dhe ja zgjati.

— Na merri dhe këto thërrime, — i tha ai.

— Jo, nuk erdha për ato, — ju përgjegj ajo dhe uli kokën e u largua me hapa të ngadaltë e me sytë e ngulur në dëborën e bardhë sikur kërkonte diçka.

«Është gjak... Po. është gjaku i shokut që u vra», — mendonte ajo me vete, «Ja edhe trasta në një vend, po ta shikoje me kujdes, kish njollë gjaku».

Shoqja u largua pak nga të tjerët dhe duke derdhur lot hapi një gropë, me qytën e pushkës, në borën e ngrirë dhe e futi atje copën e bukës që

shtrengonte në dorë, mbi të cilën dukej si rubin pika e gjakut të shokut. Pastaj ajo e mbuloi atë dhe u kthye në mes të shokëve pa u thënë gjë atyre.

Kur i erdhi radha partizanit që ndante bukën, për të marrë copën e tij ai hoqi nga balla e fishekëve që ishin në ballancë një fishek dhe e la atë me katër. Pastaj peshoi bukën dhe e vuri mënjanë.

Komandanti dhe komisari muarën bukë të fundit, por aq sa të tjerët.

Pasi mbaroi ndarja e bukës çeta u nis që nga mali me dëborë, përmes tufanit për të filluar sulmin mbi fashistët.

TAKIM ME OTO MYLERIN

Gjermanët kishin zënë kalanë e Borshit e s'po tundeshin që andej. Aty kishin vendosur edhe një top, e here pas here qëllonin me të në drejtime të ndryshme. Vetëm kur largoheshim ne për disa ditë, gjermanët dilnin nga kalaja dhe shkonin në fshatin më të afërt, ku digjnin, vrisnin dhe grabisnin. e pastaj ktheheshin prapë dhe mbylleshin brenda mureve të larta.

Ne e sulmuam kalanë disa herë, por nuk mundëm ta merrnim dot.

— Të mos lodhemi kot, — propozoi pas një sulmi pa sukses, partizani i vjetër Rexho. — Të largohemi e të mos dukemi këtej ca ditë. Mbase u del frika e dalin nga strofka, pastaj shohim e bëjmë.

Kështu u bë. Ne nuk u dukëm më në afërsi të kalasë, por u organizua një vrojtim i fshehtë mbi veprimet e armikut dhe të gjitha lëvizjet e gjermanëve komanda jonë i merrte vsh.

Nuk pritëm gjatë. Një paradite dy skuadra gjermane dualën nga kalaja dhe duke ecur me kujdes shkuan në fshat. Mbas pak në qiell u ngjitën

shtëllungat e tymit të kasolleve dhe të shtëpive që po digjeshin, dhe u dëgjuan të thirrurat e plakave e pleqve që s'kishin pasur mundësi të iknin. Tashti po i pushkatonin gjermanët.

I sulmuam. Sulmi që i papritur për ta. Disa u shtrinë të vdekur që me të shtënat e para. Disa të paktë ua mbathën këmbëve përmes plumbave, por pati edhe nga ata që zunë nga një vend e u mbajtën si derrat e as nuk iknin e as dorëzoheshin.

Pas gjysmë ore çdo gjë kish marrë fund, gjermanët u asgjësuan. Vetëm njëri prej tyre u kap rob, edhe ai jo se donte të dorëzohej, po në përleshje e sipër, trup me trup, me Rexhon, ky e goditi gjermanin me qytë në ballë aq fort sa e rrëzoi pa ndjenja në tokë. Po edhe ai nuk e kish lënë pa gjë. Rexhua doli nga ky dyluftim me një plagë të lehtë bajonete në qafë.

Kur robi u përmend, e vumë përpara dhe e shpumë në fshatin ku kishim bazën. Ishte nja njëzet e pesë vjeç, me trup mesatar, të hollë. Kishte një fytyrë të verdhë, të dobët, me ca sy pa qepalla, të shpëlarë, ngjyrë hirre. Shikonte djathtas, majtas si dhelpira kur zihet në çark. Sa herë që ndonjë partizan ose fshatar thosh ndonjë fjalë me zë të ashpër dhe e shikonte robin me inat, ai dridhej si shufra në ujë.

Pas këtij luftimi shokët u nisën shpejt për të plotësuar një detyrë tjetër, kurse unë dhe Rexhua mbetëm në fshat për të kryer ca detyra të tjera. Gjermanin e mbyllëm në një ahur afër dhe lamë një fshatar për ta ruajtur. Kur mbaruam punë, u kthyem te robi.

— Ç'do të bëjmë me këtë? — e pyeta Rexhon, duke ja bërë me kokë në drejtim të robit.

Ai u mendua pak, pastaj u përgjegj: — Do ta dorëzojmë në komandën e vendit.

U nisëm. Unë ecja përpara, kurse Rexhua pas, ndërsa robin e kishim në mes. Rruga që e gjatë dhe ne na duhej të udhëtonim disa orë përmes një pylli të dendur. Djathtas e majtas kishim dy male të larta që zgjateshin paralel me rrugën. Duke ecur, po mendohesha. «Gjermanët aty në fshat kishin vrarë ç'gjetën, po ne, pse ta zgjasim?» Papritur ndala.

— Ç'do të bëjmë? — i thashë Rexhos.

— Vazhdo rrugën, — m'u përgjegj ai.

— Me gjithë mend e ke? Të ndahemi nga shokët dhe të hamë tërë këtë rrugë kot?

— Po ç'të bëjmë? — pyeti Rexhua, duke vënë dorën në qafën e plagosur që ja kishte lidhur dosido me shami një shoqe, dhe duke i hedhur një vështrim të shpejtë gjermanit.

— Një kokërr plumbi dhe një shqelm e nën rrugë. Këpucët merri ti që je me zhapa.

— Jo! Je në vete? As që bëhet kjo.

Robit sikur i thoshte dikush në vesh që bisedonim për atë dhe jo për të mirën e tij. Nga shprehja e fytyrës së tij dukej sikur e kuptonte se ai partizani që qe ndeshur me të, të cilin vetë e kishte qëlluar me bajonetë në qafë, pa e mbronte. Kurse ky tjetri donte t'ja hante kokën. E shikonte Rexhon mu në bebe të syrit dhe fytyra e tij merrte një pamje lutëse.

— T'i biem, se mos na ikën kodoshi e na turpëron. Nuk është italian ky që të ecë përpara si sheleg.

— Edhe ne që e kemi vënë përpara këtë, nuk jemi italianë, — u përgjegj Rexhua.

U nisëm prapë. Bëmë një copë rrugë. Dielli po perëndonte dhe pylli i dendur ku gjarpëronte rruga po errësohej. Dolëm në një qafë dhe qëndruam pak të çlodheshim. Robin e urdhëruam të ulej në mes të rrugës, kurse ne u mbështetëm pak larg tij. Gjermani na shikonte si i hutuar ne, rrugën nga kishim ardhur, pyllin përreth dhe kalanë e Borshit që dukej larg. Rexhua nxori kutinë e duhanit dhe po mbushte çibukun. Në këto e sipër papritur germani u çua dhe ja dha vrapit, u bë erë, aq shpejt ecte. Ju vumë pas. Nja dy — tri herë u mata ta qëlloja, në ecje e sipër, për ta vrarë, por nuk munda sepse here fshihej pas trungjeve të trasha të lisave, e here midis meje e gjermanit fluturonte Rexhua, kështu që qe rrezik të vrisja shokun. Pas pak Rexhua e arriti. Gjermani u shtri në tokë, mbuloi fytyrën me duar dhe qante. Siç duket priste nga sekonda në sekondë t'i zbrazej mu në turë pushka e partizanit, sepse disa herë e kishite bërë hak.

— Ngrehu, edepsëz, — i tha Rexhua që e kapi pas jakës së xhaketës dhe e ngriti lart.

— Tashti s'ka burrë që ta shpëtojë, — tha ai. — Hajde ta nxjerrim lart.

Kur mbërritëm në qafë, e kapa për dore dhe i thashë të rrinte mbi një trung. Ai bindej për çdo gjë si shelegu manar.

— Hiqja këpucët që tashti, i thashë Rexhos, se do të bëhen me gjak.

— Nuk e vrasim, jo! — nguli këmbë ai.

— More, je në vete? Prapë do të iki ky.

— Edhe nie prapë do ta zëmë, por ama do ta
çojmë të gjallë atje ku duhet.

— E mbake sikur e ke kushëri, — i thashë i
zemëruar.

— Ta kisha kushëri e të kish vepruar si ky,
i kisha larë hesapet me të, po këtë nuk e dimë se
ç'është.

— E di unë se çfarë është. Këlysh i Hitlerit. T'i
cash barkun, ja gjen atë brenda sa një derr.

— Le të jetë, — tha Rexhua duke thithur
çibukun.

Gjermani duke qarë nxori nga xhepi i përpar-
shëm i xhakëtës një tok me letra, hoqi nga mesi
i tyre dy fotografi dhe ja zgjati Rexhos. Në një-
rën ishte një grua rreth të pesëdhjetave, me flokë të
rregulluara topuz në majë të kokës dhe me një fy-
tyrë antipatike të gjatë e të dobët. Në tjetrën ishte
një vajzë e re, e pashme, me flokë të zez të prerë
shkurt dhe me ca sy të bukur që shikonin me dja-
llëzi që nën vetullat e saja gajtan. Një nishan i zi
në fagen e majtë e zbukuronte më shumë fytyrën
e saj të plotë.

— Mutter, — i tha gjermani, duke treguar me
gisht fotografinë e gruas.

— E paska motër, — tha Rexhua. — Paska
mësuar edhe ndonjë fjalë, shqip, biri i dreqit.

— Mutter, mama, — përsëriti gjermani dhe ja
dha të qarit.

— Ama ç'e paske kuptuar! — i thashë Rexhos.
— E paska mëmë.

Pas fotografisë së vajzës ishin shkruar disa
radhë gjermanisht. E vetmja gjë që mundën të le-
xonim ishte emri Margarita në fund.

— Margarita? — e pyeta robin duke vene gish-
tin tim mbi buzët e vajzës në fotografi.

— Javol, — pohoi shpejt me kokë robi, pas-taj duke treguar veten e tij me gisht shtoi: — Oto Myler.

— E quakan Oto Myler, — i tha Rexhua. — Këtë më duket do të na thotë, apo jo?

— Po, por a e kupton ti Rexho pse na i tregoi fotografitë? Domethënë që të na vijë keq për të se ka nënë.

— Po, ashtu është, — u përgjegj Rexhua.

— Po dhe ajo plaka, që vranë këta aty në fshat, të cilën ndofta e ka vranë ky me dorën e tij, ka djem e vajza.

— Ashtu është, — tha Rexhua dhe uli kokën.

— Rexho, meqë desh të ikte, tashti e ka hak ta vrasim.

— Po ta ketë hak, e vrasin, mos u mërzit ti, — ma preu shkurt Rexhua.

Ju afrova gjermanit, i vura grykën e pushkës nën mjekër dhe i çova kokën lart.

— Thuaj «kaput Hitler», — i thashë.

Aj rrinte si shurdh e memec.

— Thuaj «kaput Hitler» i bërtita.

Gjermani tundi kokën në shenjë kundërshtimi.

— E shikon që ka Hitlerin në bark? — ju drejtova Rexhos. Edhe Rexhua u nxeh, vetullat e tij të zeza e të trasha u bashkuan në ballin e rru-dhosur.

— Mos ju afro shumë me armë të mbushur, se mos të hidhet këlyshi i qenit. tha ai dhe flaku fo-tografitë te këmbët e gjermanit.

Unë bëra katër — pesë hapa pas, shenjova me pushkë mbi të dhe, me gjithë mend isha du-ke e vranë, sepse tashti edhe Rexhua u zemërua me të dhe nuk ngulte këmbë për ta shpëtuar. Kur isha

duke e shenjuar më mirë, gjermani u çua dhe thirri me sa fuqi që pati, sa ai zë u dëgjua deri larg në mes të atij pylli.

— Kaput Hitler, kaput Hitler!

— Thirr më fort, — i bërtita dhe pushkën s'e hiqja nga *pozicioni* gati për të qëlluar.

Ai sikur e kuptoi.

— Kaput Hitler, kaput Hitler, kaput Hitler...!

Rexhua më kapi pushkën.

— Lere të birin e dreqit. Ulu tashti se ta bëri qejfin, e shau dhe Hitlerin, — pastaj i lidhi duart e robit me një palë zinxhirë apostafat për atë punë.

U nisëm. Rugës na zuri nata. Në komandën e vendit mbërritëm vonë. U ulëm nën një rrap të madh. Rexhua nxori nga çanta e tij një copë bukë të madhe dhe një kokërr qepe, i rregulloi në tri pjesë të barabarta dhe na i ndau. Gjermani hante me oreks bukën e misrit me qepë. Pastaj, me radhë, unë me Rexhon pushuam. Gjermanin nuk e zinte gjumi, kthehej sa nga njëra anë në tjetrën. «Kushedi ç'plane thurte në kokë, mendova me vete». I vajta pranë, i vura dorën në sup dhe me shenjë i thashë të flinte, se ndryshe është kjo, dhe i tregova grykën e pushkës. Ai, s'lëvizti më, duket e zuri gjumi.

Në mëngjez e dorëzuam robin dhe deshëm të largoheshim, po shoku që ishte aty përgjegjës na ndali dhe na ftoi të hynim brenda pas tij. Aty ishin dhe dy shokë të tjerë. U ulëm shtruar.

— Pa na thoni, na pyeti përgjegjësi, ku e kapët e si e kapët këtë gjerman?

Ju përgjegj Rexhua mbi rrethanat e luftimit dhe vendin ku u kap robi.

— A u vranë shokë nga tanët? — pyeti një tjetër nga ata të tre.

Ju përgjegjëm edhe kësaj pyetjejeje.

— Ky vetë si luftoi, derrçe apo nga nevoja? — pyeti prapë përgjegjësi.

— Derrçe, ju përgjigja unë. — Ja, ky e plagosi Rexhon.

— Të pushkatohet, — tha njeri nga të tre shokët e komandës së vendit.

Mua m'u bë qejfi.

— Pa dale, — ndërhyri Rexhua. Po të më pyesni mua, unë them t'ja falni jetën. Nga këta masakrenj u vranë atje në luftë sa i hëngri dreqi. Këtë që ra rob lereni, mbasi ndonjëherë e kupton se ku i shpuri ai Hitleri i tyre.

Shokët diskutuan gjatë. Më në fund vendosën që robi të mos vritej.

Ne u larguam për te shokët. Gjermani na shikonte me sytë e tij si të gjarpërit dhe ndofta priste që ne t'i flisnim, por ne u larguam për në luftë, për të asgjësuar dhe kapur gjermanë të tjerë.

Lufta mbaroi. Shpeshherë kur takoheshim me Rexhon midis episodeve të tjera nga lufta kujtonim edhe ndodhinë me robin Oto Myler, kështu që ky emër padashur na kishte mbetur në kujtesë.

* * *

Kaluan shumë vite. Edhe ne domosdo nuk ndejtëm ata që ishim, tek-tuk na dolën thinjat.

Një pasdite më muarën në telefon nga rrethi.

— Dëgjo! — më thotë nënkryetari. Nesër do të kalojë aty në Borsh një maqinë me turistë. Kanë shfaqur dëshirën të ndalojnë edhe aty. Sidoqoftë

po ndaluan, ti, si kryetar i këshillit popullor, tregoju ndonjë kuriozitet.

— Mirë, — i thashë pa e zgjatur dhe mendova që të nesërmen të merresha me ca punë të fshatit, pa u larguar shumë nga qendra.

Aty nga ora dhjetë vjen një autobus, i ri fare, mbushur me të huaj. Maqina ndaloi mu përpara zyrës së këshillit ku është dhe një burim me ujë të ftohtë bore.

Turistët njëri pas tjetrit zbritën të gjithë, e po shikonin me interesim detin e kaltërt në jugë, kopshtet me portokalla e limona, shtëpitë e reja të ndërtuara me gurë të skalitur, malet e larta që janë si kurorë përreth fshatit dhe kalanë të ndërtuar mbi atë shkëmb gjigant.

— Do të rrinë nja dy orë këtu, — më tha shoku shqiptar që i shoqëronte.

— Le të rrinë sa të duan, i thashë. Nga ne ke nevojë për gjëkafshë?

— Jo, ju faleminderit, — m'u përgjegj. — Po sikur të na pyesin, çfarë gjëje interesante për t'u treguar ka këtu?

— Nga ç'shtet janë? — e pyeta.

— Gjermanë.

— T'i shpiem në kala. Është e bukur dhe veç kësaj, që aty duket deti më mirë edhe vendin mund ta shikosh nga të gjitha anët.

— Po mirë, ja ta zëmë se i shpëmë atje, po di t'u thuash nja dy fjalë për ndërtimin e saj, se unë nuk jam i pregatitur.

— Historinë, kur është ndërtuar e si është ndërtuar, kush që i pari që vuri gurin e kush bëri llaçin, unë nuk e di, por, po të duan, mund t'u them si kemi luftuar ne kundër gjermanëve, këtu në kala.

Turistët pas pushimit të shkurtër u grumbulluan dhe po bisedonin me shoqëruesin. Unë, nga shenjat që ata bënë me dorë e kuptova se donin të ngjiteshin në kala. U nisëm. Midis tyre kishte edhe gra. Pranë meje zënë për krahu me një grua, ecte një burrë që i kishte kaluar të dyzetat. Ishte i verdhë dylë dhe i dobët, me trup mesatar. Në fytyrë kish ca pika të rralla vrarëlie, kish ca sy të shpëlarë, por të lëvizshëm. Në dorë mbante një aparat fotografik. Ecte duke biseduar me gruan që kishte për krahu. Që në hapat e para më bëri përshtypje shikimi i tij kurioz, që kalonte sa nga njëri drejtim në tjetrin. Duke ju ngjitur rrugës, kalonin pranë qendrave të zjarrit për mitralozat, të ndërhuara nga armiku qysh në kohën e luftës. Turistët i shikonin me kujdes. Kur u afruam në një kthesë rruge, turisti që ecte pranë meje, ndaloi, pregatiti aparatin dhe drejtoi objektivin mbi një qendër zjarri. Unë menjëherë i dola përpara dhe nuk e lejova të fotografonte.

— Thuaju, ju drejtova shoqëruesit, që pa leje të mos fotografojnë asgjë. Si nuk i paske porositur që kur u nise me ta?

Shoku u foli diçka në gjuhën e tyre. Ata diçkanë me njëri — tjetrin, të pakënaqur. U nisëm. Kur dolëm te ca troje të vjetra, unë ndala dhe prita sa të grumbulloheshin të gjithë.

— Ja, këto shtëpi i kanë djegur gjermanët, i thashë shokut shoqërues. — Këtu kanë vrarë dhe një grua, që nuk mundi të ikte, sepse atë ditë lindi. Përkthejua t'i dinë! Ja varri i saj!

Shoku ua përktheu por mua m'u duk sikur foli më gjatë, se sa i thashë unë. Unë vura re se disa prej tyre ulën kokën dhe m'u duk sikur i vriste ndër-

gjegjja për veprimet e bashkatdhetarëve të tyre. Kurse turisti që ecte afër meje lëviste kokën majtas e djathtas, sikur nuk i dëgjonte mirë ato që thuheshin.

— Kurse aty vranë një plakë, vazhdova unë duke treguar me dorë në drejtim të ca mureve të rrëzuara.

Disa prej turistave ju drejtuan shoqëruesit dhe diç i thanë.

— Pyesin, në mund të fotografojnë shtëpitë e djegura?

— Posi, me gjithë qejf. Le të fotografojnë, dielli është i mirë, kështu që dalin bukur.

Turistët fotografuan gërmadhat që kishin bërë bashkatdhetarët e tyre. Turisti që ecte pranë meje dhe që desh të fotografonte qendrën e zjarrit nuk fotografoi. Gruaja që kish për krahu diç i foli, bile ashpër. Ishte grua e pashme, me flokë të zez, vetulla të zeza e fytyrë të bardhë, të mbushr. Kish ca sy të gjallë të bukur, ndërsa nishani i zi në faqen e majtë e bënte edhe më tërheqëse gjermanen.

U tregova dhe ngjarje të tjera gjatë rrugës për në kala. Shoqëruesi ua përkthente, kurse ata, donin s'donin po dëgjonin ato që u thuheshin.

Po i afrohem kalasë. Për t'u ngjitur në të, ka dy rrugë, njëra është rruga kryesore që shkon drejt ballë për ballë, por të bie pak më e gjatë dhe tjetra është një rrugicë e ngushtë që përmes një shtegu të nxjerr më shpejt. Por këtë rrugicë e dinë vetëm fshatarët, dhe jo të gjithë, ose ata që kanë ndejtur në kala. Aty ku ndahen rrugët, unë qëndrova pak pas për të ndezur një cigare. Për çudinë time shoh që gjermani që ecte afër meje mori rrugës së shtegut.

— Jo andej, i thirra unë, sepse s'doja që ata

t'i mësonin të gjitha shtigjet, andej s'ka rrugë, hajdeni pas meje.

Shoqëruesi i përsëriti gjermanisht fjalët e mia. Turisti u kthye. Unë mendohesha: «Ku dreqin e di ai këtë rrugë qorre, që as të gjithë fshatarët nuk e dinë? Apo ndofta rastësisht shkoi andej?»

U ngjitëm në kala. Për disa minuta turistët u shpërndanë andej — këndeje. Gratë mblidhnin manushaqe dhe agulice e po bënë tufa, kurse burrat po bisedonin së bashku.

Gjermani që gjatë rrugës ecte pranë meje, shkonte sa nga një qoshe e kalasë në tjetrën. E vura re me kujdes. Shikonte në drejtim të fshatit fqinjë, pastaj në drejtim të grykës midis dy maleve të larta ku gjarpëronte rruga që të shpie në një fshat tjetër. Sytë e tij lëviznin si sytë e qenit. Për çudi më dukej sikur ata sytë e shpëlarë i kisha parë diku. Po duke menduar kështu, qeshja me vete: «Sa i çuditshëm jam, ku do t'ja shikoja fytyrën unë këtij turisti. Gjermanët vërtet kanë qenë gjatë luftës në Shqipëri, por e para e punës, ata nuk kanë qenë të gjithë këtu, se ka pasur edhe në shtete të tjera, dhe e dyta, ne nuk kemi ndejtur asnjëherë shtruar e të shikoheshim sy me sy me ta, po kemi luftuar, sepse i kemi pasur armiq.»

— Kanë dëshirë të dinë diçka për kalanë, — më thotë shoku që i shoqëronte turistët. — Do t'u thuash ndonjë gjë?

— Posi. Me gjithë qejf.

Gjermanët u grumbulluan afër meje. Unë hipa mbi një gur katërkëndësh të madh e të skalitur dhe fillova t'i thosha shoqëruesit ç'kisha dëgjuar nga plakat dhe pleqtë e fshatit mbi ndërtimin e kalasë dhe mbi luftërat që ishin bërë aty.

Shoku i përkthente, besoj edhe duke i zbukuruar një çikë, si njeri me shkollë, sepse, kur ke shkollë, di t'i thuash më bukur ato që di e që ke dëgjuar. Turistët dëgjonin. Unë gjatë kohës që përkthente shoqëruesi, i shikoja me radhë ata. Për çudi edhe atë gruan me sy të bukur e me nishan në faqe më dukej sikur e kisha parë. «Sot qenkam budallepsur fare, mendoja. Mirë atë që është burrë, po këtë gruan ku do të mund ta shikoja? Gjepura!»

Më në fund u tregova për luftën partizane. U fola se si gjermanët ishin futur këtu në këtë kala, si diinin herë pas here për të djegur, vrrarë e plaçkitur dhe si ne i gënjem e i shpartalluam.

Shoku përkthente ngadalë dhe i vura re se gjithmonë fliste më shumë se unë. Turistji që ecte përkrah meje gjatë ngjijtjes në kala, po dëgjonte me buzë në gaz.

— Këtu kemi zënë edhe një nënoficer gjerman rob, e quanin Oto Myler, u tregova unë duke qeshur.

Gruaja me sy të bukur papritur të përkthehe-shin fjalët e mia, lëshoi një klithmë habie. Edhe disa të tjerë lëvizën nga vendet dhe thërrisnin gjëra të pakuptuara, duke qeshur e duke u tallur. Ata të gjithë i drejtoheshin turistit me sy të shpëlarë, i cili qendronte pas të tjerëve.

Vazhdoi për disa minuta shkëmbimi i fjalëve dhe talljeve midis njërit dhe tjetrit.

— Ç'dreq kanë kështu? — e pyeta shoqëruesin.

— A e di pse po ndodh ky pështjellim? — m'u përgjegj ai.

— Jo, i them. Nga ta di unë kur s'ua di gjuhën?

— Ai robi që keni zënë ju, është këtu, ja ai që i drejtohen të tjerët.

U habita. S'ma priste kurrë mendja qe robi Oto Myler që për një qime shpëtoi nga plumbi, (dhe këtë t'ja dijë për nder partizanit Rexho) të vinte prapë këtu si turist.

Ju afrova turistit Oto Myler. Ai më shikoi me kujdes, pastaj i foli gruas me sy të bukur.

— Margarita? — e pyeta duke treguar me gisht gruan.

— Javohl, — tha ai shpejt. — Kurse gruaja ha pi sytë e saj të bukur, e çuditur.

Gjermanët u grumbulluan dhe po rrinin të heshtur.

— Thuaj, a e ka kuptuar ku i çoi Hitleri? — i thashë shoqëruesit, i cili ja përktheu fjalët e mia.

— Detyra është detyrë, — u përgjegj Oto Myleri.

— Po sikur të të nisin prapë me detyrë për të vrrarë dhe djegur popujt, a do të pranoje?

— Detyra është detyrë — u përgjegj prapë ftohtë ish robi.

— Gjarpërit i duhet shtypur koka, — i thashë ngadalë shoqëruesit.

Oto Myleri m'u afrua dhe pasi e hetoi për një çast fytyrën time, diç i tha gjermanisht përkthyesit. Pastaj më shikoi prapë mua me ata sytë e shpëlarë e përsëriti në mënyrë pyetëse:

— Rexho, Rexho?

E mbajtka mend bukur qerratai.

Kur ai i tregoi gruas se unë kam dashur ta vras, ajo më shikoi me inat dhe sytë e saj të bukur shprehën egërsi.

Turistët ikën, kurse unë që atë ditë, i shkrova një letër Rexhos në fshatin Zhulat, ku i transmetoja «të falat» e Oto Mylerit.

GRIMCA NGA JETA E NJE HEROI

Gjatë gjithë natës patëm një stërvitje të gjatë dhe të lodhshme. Aty afër mëngjezit, kur nga lindja horizonti sapo kish filluar të zbardhëllonte, bëmë pak pushim. Yjet e rrallë e të ndritshëm, që akoma qëndisnin qiellin e kthjellët, dalëngadalë po e humbisnin shkëlqimin e tyre, po shuheshin njëri pas tjetrit.

Komandanti ndezi një cigare dhe po bisedonte me një oficer të ri që nuk kishte vepruar drejt gjatë stërvitjes, i bënte atij vërejtje dhe i tregonte se si duhej të vepronte në të ardhmen. Pastaj e lejoi oficerin të largohej, ndërsa vetë nxori nga çanta një hartë, e shtriu përpara dhe duke e ndriçuar me një elektrik xhepi, hidhte në të, me lapsa ngjyrash, ca shenja të nevojshme për vazhdimin e mëtejshëm të stërvitjes. Në këtë kohë disa ushtarë, që siç duket s'pyesnin për lodhje, ja muarën një këngë labçe:

*«Mezhgorani shkëmb e brinjë,
Grykë e Këlcyrës u nxi...»*

Komandanti ashtu siç ishte, me laps në dorë, fiku elektrikun dhe po dëgjonte këngën.

«...Trebeshina mal i lartë
Nga xhadeja vjen ushtri...»

Në majën e kodrës një grup ushtarësh, të mbledhur në formë rrethi, i kishin hedhur duart në supe njëri — tjetrit e po këndonin. Në atë mugëtirë dukej sikur mbi kodër ishte ngritur një kësh-tjellë, kokat e ushtarëve dhe hapësirat midis qafave të tyre krijonin pamjen e bedenave të kështjellës.

Më bëri përshtypje se si komandanti ndërpreu punën dhe dëgjonte i përqëndruar këngën, gjë që s'e kisha vënë re her tjetër kur ushtarët këndonin labçe. U ktheva nga ushtarët që po këndonin. Aty midis labërve që ishin kapur sup në sup, pashë edhe Prengën nga Mirdita. Megjithatë kënga shkonte për mrekulli. Mendova se edhe komandantit kjo i kishte bërë përshtypje.

— Ka mësuar Prenga, aq mirë, sa s'e dallon dot në është nga veriu, apo nga jugu, — ju drejtova komandantit.

— A e ke njohur Asim Zenelin? — më pyeti ai.

— Nuk e kam njohur, por kam dëgjuar dhe kam lexuar për të, — i thashë.

— Ti mund të kesh dëgjuar dhe lexuar shumë për Asim Zenelin, kështu që mund ta përfytyrosh portretin e plotë, forcën dhe heroizmin e këtij luftëtari por sidoqoftë ndryshe është ta kesh njohur së afërmi dhe të kesh luftuar krah për krah me të. — Ai ndezi një cigare, e thithi atë thellë dhe, duke e ngulur për një çast shikimin në diskun e kuq të diellit që po lindte, filloi të më tregonte disa kujtime interesante lidhur me takimet e tij të para me trimin partizan, të cilat duke i vënë në këto pak rrjeshta i quajta: «Grimca nga jeta e një heroi».

Ishte dimri i vitit 1942. Ka qënë një ditë e vrejtur dhe e ftohtë. Rrezet e diellit rrallë ndriçonin tokën, sepse retë pothuajse kishin mbuluar qiellin. Ne, një grup shokësh trëmbëdhjetë — katërmbëdhjetë vjeçarë ishim mbledhur tek Bregu i burrave dhe, rreth një plepi, ca ulur dhe ca në këmbë, po shikonim me shumë kureshtje një pistoletë të Novruzit, të njërit prej shokëve tanë. Për ne pushka nuk qe aq interesante, sepse pushkë kishte çdo shtëpi dhe mund t'i merrnim, t'i mbanim në krah, bile dhe të qëllonim me to, por që të kishe një pistoletë, kjo qe një punë tjetër.

— Pistoletën mund ta mbash kollaj dhe ta fshehësh dhe në xhep të pantallonave po qe nevoja, — na thoshte Novruzi. Pastaj shikoni si feks kjo, kurse pushka është si shul i gjatë që ne s'e mbajmë dot, se na hiqet zvarrë për tokë.

Ne e shikonim dhe e shikonim pistoletin dhe prapë nuk kënaqeshim. Donim ta mbanim sa më shumë në duar, e vinim në brez, shenjonim me të në drejtime të ndryshme, ose ja drejtonim ndonjë shoku në lule të ballit dhe thoshim me gojë: «Pam, të vrava!»

Në qiellin e vrejtur u dëgjua një zhurmë aeroplani. Të gjithë kërkuam me sy në drejtim të zhurmës, dhe ja, pamë një aeroplan me dy krahë që si një zog i zi fluturonte ngadalë në drejtimin tonë. Në këtë kohë pistoletin e kisha në dorë unë. Novruzi ma rrëmbeu me të shpejtë dhe, duke mbyllur njerin sy, e drejtoi grykën e pistoletit mbi aeroplan.

— A e rrëzon dot? — e pyeta unë.

— E rrëzoj dhe ja ha kokën, — u përgjegj Novruzi.

— Po bjeri atëhere, ç'pret, — tha një shok tjetër.

— Dale sa të afrohet dhe pak — tha Novruzi që vazhdonte të ndiqte lëvizjen e aeroplanit me dorë të shtrirë në hapësirë.

Pam! U dëgjua krisma. Ne të gjithë u mbërthyem në vend e shikonim si do të goditej aeroplani e si do të rrëzohej. Kaluan disa pak sekonda. Na vinte inat sepse ai ecte aq ngadalë, sa që na dukej sikur nuk na përfillte fare.

— Pistoleta s'qenka gjë — tha një nga shokët tanë, — pushka ja tregon qejfin atij kodoshi, që shkon si në dasmë.

Novruzi pa folur e vuri në brez pistoletën. Na kujtohej nga koha e luftës italo — greke, se si disa herë aeroplanët, pasi ishin qëlluar nga toka, kishin marë flakë dhe, duke lënë prapa një bisht të zi tymi, ishin rrëzuar në tokë.

Në këtë kohë, në drejtim të grupit tonë po vinte tek ne një oficer. Qe e qartë se ai e kishte parë Novruzin me pistoletë në duar, jo vetëm kaq, por dhe kur kishte qëlluar, sepse vendi ku ishim ne, dukej që nga larg.

— Vrapo e ik — i bërtiti njëri nga shoket Novruzit. Por ai vetëtimthi e hoqi pistoletën nga brezi dhe e futi në mëngë të palltos. Pastaj me duart në xhepa filloi të vërshëllente. Oficeri erdhi fare afër dhe na përshëndeti.

— Mirëdita djem, si jeni?

Ishte i pashëm, me trup mesatar, flokëzi e syzi, me një fytyrë pak të hequr e buzagaze, por me një fije trishtimi. Kapotën e kishte hedhur në supin e majtë, në mëngë dhe në kapele i ndrisnin gradat, krahaqafë kishte hedhur rripin e pistoletës.

Nuk u përgjegjëm. Ne na kishin thënë shokët e luftës se fashizmi është i lig dhe se oficerët e fashizmit janë armiq, prandaj e dinim se përpara kishim një armik. Ai hoqi kapelen, fshiu ballin e djersitur me shall dhe prapë na foli:

— Me se merreni, a veni në shkollë?

— Shkolla s'ka, — i tha njeri nga shokët. — Shkolla u dogj, mësuesët kanë ikur.

— E dogjën ushtarët, nuk u dogj vetë, ndërhyri njeri nga ne, duke ju drejtuar atij që foli për shkollën.

Oficeri na shikonte me radhë nga fytyra, veshjen copë — copë, këmbët e zbathura... Po edhe ne ama na doli frika dhe tashti donim ta tregonim veten të zot, që s'trembemi, prandaj fjalosehim: njëri me tjetrin sikur të mos kishte njeri tjetër aty. Pastaj u kthyem nga oficeri që qëndronte në këmbë.

— A e do ti fashizmin? — e pyeti Novruzi.

— Po Duçen a e do shumë? — e pyeti një tjetër.

Ne qeshëm me të madhe, ndërsa njeri ndërhyri si për t'u përgjegjur në vend të tij.

— E po domosdo, edhe i do se e ushqejnë.

Nuk do ta harroj kurrë pamjen fytyrës së tij në atë çast. Ajo u bë limon, sytë muarën një shkëlqim të çuditshëm, që rrallë e kam parë te ndonjë tjetër. U kollit një herë, pastaj me zë të fortë dhe të qartë tha:

— Unë dua Shqipërinë, dua popullin tim!

Pastaj nxori nga këllëfi i pistoletës një karikatore me fishekë dhe ja zgjati Novruzit.

— Merri trim, se këta bëjnë për pistoletën tënde.

Ne u cuditëm me këtë oficer i cili në vend që të na bënte ndonjë të keqe për pistoletën dhe për fjalët fyëse, na dha fishekë.

Ai ashtu siç erdhi, iku me hapa të ngadaltë, rrugës për në fshatin fqinjë.

Kish kaluar më tepër se një vit. Lufta partizane kishte marrë hov të madh. Disa nga ne herë pas herë merrnim pjesë në aksionet e ndryshme që bënin çetat partizane. Kështu ndodhi që një herë para një luftimi u mblodhëm së bashku me çetën «Hajredin Tremishti» nën ca rrapa shekullorë dhe po prisnim natën që të niseshim për në vendin e aksionit. Partizanët takoheshin njeri me tjetrin, putheshin, përqafoheshin, çmalleshin me shokët që kishin ditë pa u parë. Po të gjithë ama nuk i flisnin njëri-tjetrit me emrin e vërtetë, por me pse-udonimin.

— «Mali», ku je?

— «Dyfyek», shpirti i vëllait, gjallë je?

— Gjallë, gjallë o «Lis». Po ti si ja shpie?

Një plak rreth të shtatëdhjetave, por i fortë ama, ish ulur aty pranë, këmbëkryq, e po grinte duhan në një shami të kuqe. Në vend të drurit kishte vënë qytën e pushkës. Unë me një shok moshatar, nga fshati, ishim ulur afër njëri - tjetrit dhe po hanim bukë me gjizë, që ma kishte dhënë mua me vete një plakë e dhëmbshur në shtëpinë që kisha qënë për drekë.

— Xhaxho, pushka s'është për ta bërë dru duhani, — i them unë, por për luftë.

— Ha aty bukë, pa do ta shohësh se përse është pushka, sonte, natën. Mos më mëso mua ti. — tha ai pa e kthyer kokën dhe vazhdoi të grinte duhan.

Në këtë kohë kaloi aty një partizan që u ul barkaz e piu ujë në përruan që gurgullonte me zhurmë. Kur u kthye, ecte ngadalë dhe sytë i kishte ngulur te plaku që grinte duhanin. Në dorë mbante një belçik të ri. Kishte një gjerdan meshini të verdhë me pulla të ndritshme me dy radhë krehëra fishekësh. Dukej sikur çalonte pak. Na shikoi edhe ne, në fillim si shkarazi, pastaj na i nguli si shigjeta sytë e tij të zinj dhe po na vërente me radhë, herë mua, herë shokun, aq sa ne u hutuam dhe as që mundëm t'i thonim ndonjë fjalë, ose ta pyesnim.

— Xha Kanan — i tha plakut — si je? Mos u lodhe?

— Jo or bir, nuk jam lodhur, kjo e pritur kështu na lodh. Më mirë huxhum dhe të venë në djall këta breshkamëdhenjtë.

— E po çdo gjë në kohë të vet. Po do të prishësh pushkën duke grirë duhan në të, — i tha ai si me të qeshur.

— E kam që në kohë të Turqisë këtë mauzer dhe do mbetet dhe pas meje, të luftojnë dhe djemtë e mi me të.

Partizani u largua më tutje dhe u ul e po bisedonte me ca shokë të tjerë.

— Fytyrë e njohur — i thashë shokut, kush është ky, e njeh ti?

— Edhe unë e kam parë, po ku, sikur të vdes nuk e mbaj mend.

— O xha Kanan — ju drejtuam ne plakut, pasi tashti e mësuam se si quhej, cili që ai shoku që kaloi këtu?

— Qysh more edepsëza, vërtet nuk e njihni dhe doni të delni partizanë? — na shau xha Kana-

ni. — Më mirë ikni bëhuni synet një herë, pastaj merrni dyfeqet e delni maleve, koka juaj.

— Pse, që të jesh partizan, dashke t'i njohësh të gjithë?

— Të gjithë, kuptohet që jo, por atë ama duhet ta njihni, tha ai i zemëruar, pastaj si më i qetë shtoi:

— Në vitin 1914, kur luftonim kundër grekut, njerin, kështu si ju, që nuk njohu Çerçiz Topullin, e ndoqën nga çeta. «Ç'komit je ti? — i thanë, kur nuk njih komandantin tënd» — dhe ai iku i turpëruar. Kështu që edhe ju duhet ta njihni. Ai është Asim Zeneli, komandanti i çetës.

Emër i dëgjuar për ne, por ama dhe fytyrë e njohur. Si t'i lidhnim këto me një të vetme, nuk e merrnim me mend. Kushedi sa herë kishim dëgjuar të flitej për Asimin, dhe me emër e njihnim, por si fytyrë jo. Por dhe fytyrën e këtij partizani, ne sikur e kishim parë diku.

Fillin e këtyre mendimeve na e ndërpreu prapë xha Kanani.

— Ky ka qënë oficer, po e bëri tamam forra, ashtu si bir i këtyre maleve që është — tha ai me një zë që tregonte krenari.

«Ky ka qënë oficer! Ne ku ta kemi parë vallë»? Mendonim të dy dhe gërmonim në kujtesën tonë.

— More, më duket se është ai oficeri që na dha karikatorein me fishekë — i thashë shokut.

— Atë mendoj dhe unë, ai më duket, po, po ai është, tashti m'u mbush mendja top.

— S'ka tjetër, ai është, ngreu të vemi ta pyesim.

U çuam pa përtuar dhe u drejtuam për te ai. Sa na pa, qeshi, u dukën ca dhëmbë të rregullt, në

mollëzat e faqeve u formuan dy gropëza të vogla. U çua dhe, duke përkulur pak kokën anash, na shikonte me dashmirësi.

— Më duket ju njoha, — na tha.

— Nuk e dimë, edhe ne na duket se të njohëm.

— «A e doni Duce»? — na pyeti.

— «Ne duam Shqipërinë, duam popullin tonë» — ju përgjegjëm me zë të lartë.

— Po, tashti u njohëm tamam. Bravo, ju lumtë! Edhe ju e paskeni marrë pushkën, — na tha. Unë ashtu mendoja se ju do të luftonit kundër fashizmit. Pastaj na përqafoi dhe na pyeti për shokët e tjerë, të cilët i mbante mend.

Mbrëmja erdhi. U dha urdhëri që të niseshim për rrugë. Asimi atë ditë ishte me ethe, prandaj i kishin gjetur një kalë për t'i hipur. U nisëm. Rruga ishte e keqe, tërë gurë. Asimi ecte në mes të çetës. Përpara kishte një shok me këpucë të grisura, që i kishte hequr dhe i mbante në njërën dorë, se siç duket edhe i vrisnin këmbët.

Ai, kur vuri re se shoku ecte zbathur, i thirri ngadalë:

— Shoku «Beleg»! Ndal, merr këpucët e mia, derisa të vemi në vend!

— Në asnjë mënyrë, shoku Asim!

— Ndal, po të them, se je zbathur, kurse unë jam kaluar.

— Shoku Asim, as që e ndjej, se mos jemi mësuar ne me këpucë — i tha ai duke qeshur dhe vazhdoi rrugën.

Asimi zbriti nga kali.

— Atëhere hip në kalë ti që je zbathur, — i tha partizanit.

— Po ti shoku Asim je i sëmurë.

— S'ka gjë, e ndjej veten mirë.

— Më mirë më jep këpucët dhe ti hipja kalit, — i tha partizani, kur u bind se Asimi vazhdonte të qëndronte në të tijën.

Ai hoqi këpucët, i ndërroi me partizanin dhe pastaj ja hipi kalit e u nis midis shokëve të çetës për në aksion.

Pas ca ditësh ai u vra në grykën e Mezhgoranit, ku luftoi si hero, dhe për atë këndohet e do të këndohet brez pas brezi, kënga që dëgjuam nga ushtarët, kurse mua, sa herë që dëgjoj të këndohen këngë për të, më del përpara Asimi, nganjëherë me karikaturen e fishekëve në dorë, që ja zgjat Novruzit dhe nganjëherë duke i ndërruar këpucët me partizanin «Beleg.»

ZBULUESI

Sipas një episodi të ngjarë në provokacionet e gushtit 1949.

Pas luftimesh të ashpra, monarko-fashistët grekë e kapën majën e kodrës sonë dhe po hapnin llogore për t'u forcuar në të. Komandës ju vu detyrë që të kundërsulmonte dhe të zbrapste armikun.

Strehimi i vendkomandës ishte ndërtuar në faqen e një shpati dhe qe maskuar me plisa e me gjethe aq me kujdes, saqë, edhe po të kaloje mbi të, nuk mund ta diktoje dot. Në hvrje, me automatik në gjoks, bënte roje zbulues Bariu. Ishte natë. Qielli ish mbushur me copëra resh, përmes të cilave, herë pas here, shkëlqenin yjet e arta.

Komandanti dhe komisari kishin rënë në mendime të thella. Ata i shqetësonin pyetjet e zakonshme, që i dalin çdo komande para se të bëhet plani i luftimit: Ç'forca ka armiku? Si i ka vendosur ato? Morali i tyre, organizimi i sistemit të zjarrit, punimet fortifikuese e tjera. Ata mendohehin, në bazë të informatave që kishin, t'u jepnin

përgjigje këtyre pyetjeve. Por informatat qenë kontradiktore. Sipas disa të dhënave tona, dilte një situatë, kurse sipas pohimeve të një oficeri monarko-fashist, që ishte kapur rob një ditë më parë, dilte një situatë tjetër. Komandanti dhe komisari i krahasonin ato, i vlerësonin duke u nisur nga principet taktike të armikut, nga eksperiencia e tyre, si dhe nga pozicioni i kodrës që kishin kapur monarko-fashistët, dhe arrinin në përfundimin se pohimet e robit nuk përputheshin ose, të paktën, nuk afroheshin me të dhënat nga burimet e tjera.

Kush kishte të drejtë?

Oficeri monarko-fashist, sigurisht, e njihte më mirë gjendjen. Ai kishte qenë vetë efektiv në atë repart të armikut, që kishte kapur kodrën, kështu që jo vetëm mund t'u përgjigjej pyetjeve që shqetësonin komandën, më saktë se kushdo tjetër, por mund të jepte edhe hollësira më të mëdha, të cilat nga ana jonë nuk mund të zbuloheshin. Robi, gjatë marrjes në pyetje, pas lëkundjeve të para, filloi të depononte mbi gjithshka që i kërkohej, me një sinqeritet të hapët, që dukej se s'linte asnjë mundësi për të dyshuar.

Por informatat tona binin në kundërshtim me thënjet e robit.

Tanët, natyrisht, ishin munduar si për vete. Për ta vlerësuar sa më saktë situatën e armikut, ata i kishin shoshitur disa herë informatat e ndryshme dhe pastaj kishin nxjerrë variantin më të besueshëm.

Komandanti u çua nga stoli ku ishte ulur, shkoi pranë një tavoline të vogël, që qe vendosur në mes strehimit, sipër së cilës qe shtrirë një hartë e atij rajoni dhe shikoi me kujdes gjërat që qenë shënu-

ar në të. Komisari mori një fletore, e vuri mbi gju-një dhe nisi të shkruante i përqëndruar.

Zbuluesi ndiqte me kujdes veprimet e koman-dantit dhe të komisarit. Ai e kishte kuptuar shqetësimin e tyre dhe po vriste mendjen si t'i ndih-monte.

— Duhet thirrur prapë robi, — ju drejtua komandanti komisarit me zë të qetë. — Duhet ta pyesim prapë.

— E thërresim! — ju përgjegj shokut, mendue-shëm, komisari.

Komandanti doli te hyrja e strehimit dhe thirri:

— Shoku Bari, bjereni robin këtu!

— Si urdhëroni! — u përgjegj zbuluesi dhe u nis.

Pas pak, në strehimin e komandës hyri oficeri monarko-fashist bashkë me përkthyesin. Zbuluesi qëndronte para hyrjes me sytë të drejtuar nga errësira, kurse me mendje e veshë ndiqte bisedën, që po zhvillohej midis komandës dhe robit.

— Sa forca janë në kodrën që kapët dje? — e pyeti komandanti nëpërmjet përkthyesit.

— Unë ju thashë, dy toga, asnjë ushtar më tepër.

— Shumë pak për atë drejtim të rëndësishëm, apo jo?

— Komanda jonë nuk i jepte shumë rëndësi atij drejtimi, — u përgjegj gjakftohtë monarko-fashisti, duke i ngulur komandatit sytë e tij si të dhelprës.

— Kjo është e pabesueshme. Sa vetë u vranë në luftimet e djeshme?

— Dyzet e katër.

— Si shumë?! — i tha komisari dhe e vësh-troi me dyshim robin.

— Aq u vranë. Ne lajmëruam komandën më të lartë.

— Kurse ne i raportuam komandës sonë, se në atë luftim u vranë tetëmbëdhjetë monarko-fashistë, — spjegoi komisari.

— Pak keni raportuar, atje u vranë më shumë — tha robi.

— A mund të na thoni çfarë përforcimesh kanë ato dy togat tuaja? — e pyeti komandanti.

— Pothuajse asgjë, veç dy mitralozëve të rëndë.

— Mirë, ta zëmë kështu, po detyra e tyre, pas kapjes së kodrës, cila do të ishte? — vazhdoi pyetjen komandanti.

— Të qëndronin në vend derisa të merrnin urdhër tjetër.

Komandanti e shikoi robin rreptë në sy. Monarko-fashisti u hutua dhe, duke mos mundur t'i qëndronte dot këtij vështrimi, uhi kokën.

— Ju gënjeni! — i tha komandanti shkurt, por ashpër.

Pasi e larguan robin, komandanti dhe komisarri u afruan rreth tavolinës, ku ishte shtrirë harta, e duke shikuar në të, zunë të bisedonin.

Ishte koha, që duhej të pregatitej plani i luftimit për marrjen e kodrës dhe zbrapsjen e agresionit të monarko-fashistëve, më shumë se çdo gjëje, i ruheshin gabimit në vlerësimin e armikut, sidomos nënvleftësimit të tij..

— Nga pohimet e oficerit monarko-fashist na del një kundërshtar jo aq i fortë, — i tha komisari.

— Grackë. Pohimet e tij mund të jenë grackë, që kërkon të na çorientojë, — u përgjegj tjetri.

— Edhe unë atë mendoj, po në mes gjithë atyre që na tha të mos ketë diçka të vërtetë?

— Si të thuash, — u përgjegj komandanti pasi u mendua pak, po të ishte i zgjuar, duhej që, midis pohimeve të rreme, të na thoshte dhe ndonjë të vërtetë. Po se cila është kjo e vërtetë, ec e gjeje.

— Rrethanat e kapjes së robit sikur s'lënë për të dyshuar!

— Jo. Ai luftoi deri në fishekun e fundit dhe bëri të gjitha përpjekjet për të mos rënë rob.

Nga ç'kishte thënë robi, në kodrën ku do të bëhej sulmi të nesërmen, ishin dy toga të armikut. A mund t'i besohej kësaj? «Kjo, arësyetonin shokët e komandës, do të thotë që ne të hidhemi në sulm duke menduar se kemi përpara dy toga të armikut, kurse në të vërtetë mund të ndeshemi me një kundërshtar të fortë. Atëhere? Dështimi i sulmit, humbje në njerëz».

Edhe mbivlerësimi të armikut shokët e komandës i druhashin. «Mbivlerësimi ka të keqen e tij, mendonin ata, ta mbivlerësosh armikun, do të thotë, që të harxhosh forca dhe mjete pa qenë nevoja, si, për të prerë një fije peri, të përdorësh sëpatën».

Pasi shohitën të gjitha ç'kishin mësuar mbi armikun, komandanti dhe komisari u përqëndruan në përgatitjen e planit të luftimit.

Kur i shikonte kështu të shqetësuar, zbuluesit i therte në zemër, sepse mendonte, që pikërisht ata, zbuluesit, ishin fajtorë që komanda nuk kishte informatat e plota, që i duheshin për organizimin e sulmit. «Po unë vetë, ç'kam bërë? A nuk më bie edhe mua një pjesë e fajit? Po sikur komanda të marrë vendime jo të drejta, sa jetë shokësh do të na

kushtojë»? — mendonte ai, duke qëndruar në këmbë përpara hyrjes së strehimit.

Këto bluante në kokë Bariu, kur i erdhi shoku për ta ndërruar nga shërbimi. Pasi dorëzoi detyrën, nuk u largua, por u shtri në shpinë, aty afër dhe po shikonte copat e reve, që po lundronin lart në qiell dhe yjet që xixëllonin.

— Shko, çlodhu te shokët! — i tha ngadalë ushtari që e zëvendësoi.

— Do të shkoj, po ja të rri pak këtu — ju përgjegj ai shkurt dhe, në kokë, prapë i vërtiteshin pyetjet e komandantit e të komisarit dhe përgjigjet e oficerit monarko-fashist. «Komanda ka të drejtë të shqetësohet, mendonte ai, po kush tjetër do t'ua sqarojë këto pyetje, veç nesh, zbuluesve?». Pastaj, me një forcë të madhe i buçiste në kokë parulla, të cilën e kishte mësuar që ditën e parë që qe caktuar në këtë armë: «Zbulimi është syri dhe veshi i komandantit».

Filloi tek ai një luftë e brendshme, u mbush me urrejtje të papërshkruar për oficerin monarko-fashist dhe i vinte t'i zbrazte në gjoks një karikaturë automatiku. U çua në këmbë, hodhi sytë brenda në çadër dhe pa komandantin dhe komisarin, që po bisedonin qetë e mendueshëm. U shtri prapë, por nuk mundi të qëndronte gjatë. U çua dhe, pa u venë re nga askush, me automatikun në gjoks, rrëshqiti diku, përmes errësirës...

* * *

I pari monarko-fashist, që ndeshi zbuluesi, kur kaloi në prapavijën e armikut, ishte një kuzinier,

i cili po lante kazanët e gjellëve afër një zjarri të madh. «Paskam kaluar në thellësi» — mendoi Bariu duke u afruar fare afër dhe duke shikuar me kujdës vendin përreth, kuzinierin, enët e gjellëve dhe që aty u bind se oficeri monarko-fashist, me përgjigjet e tij, e kish mashtruar komandën tonë. «Armik i vendosur» — mendoi ai për robin dhe vërejtji prapë me kujdes kuzinierin dhe kazanët. «Edhe kazani ka gjuhë njëlloj si kuzinjeri» mendoi ai dhe vuri buzën në gaz. I lindi mendimi të merrte kuzinierin me vete dhe të kthehej pa humbur kohë në komandë. Kur po bëhej gati të zbatonte planin e tij, i lindën disa pyetje, të cilat e bënë të mendonte akoma:

«Çfarë mund të dinte kuzinieri?»

«Forcën e efektivit që ushqen dhe numrin e repartit. Tjetër, asgjë».

«Po kush do t'u përgjigjet pyetjeve të tjera të komandantit e të komisarit?»

«?»

Zbuluesi hoqi dorë nga ky mendim, dhe u nis me të shpejtë lart, drejt majës së kodrës, kurse kuzinieri ja mori një kënge të shtruar, duke vazhduar të lante enët.

Asaj nate të errët me vështirësi mund t'i dalloje konturet e kodrave përreth dhe përrenjtë. Vendi ishte i veshur me dushk të shkurtër.

Pasi eci ca, zbuluesi dëgjoji goditjet e kazmave të ushtarëve armiq, që hapnin llogore dhe bënin pozicione. U afrua në atë drejtim. Aty afër vuri re një top. Një ushtar monarko-fashist, që dukej se qe roje, po shëtiste tutje e tëhu me pushkë në krah. Bariu e pa me kujdes topin, përcaktoi kalibrin e tij dhe u nis më tej. Vuri re ushtarët mo-

narko-fashistë, nga të cilët disa bisedonin, disa ishin shtrirë e po flinin, kurse të tjerët lëviznin për diku. Duke kontrolluar me radhë në atë rajon, zbuloi katër topa dhe dy tanksa, që në atë errësirë ngjanin me përbindsha. Në këtë kohë, që nga maja e kodrës, dy raketa të verdha, njëra pas tjetrës u ngjitën lart në qiell. Zbuluesi u shtri barkaz me të shpejtë, dhe po shikonte me kujdes përreth. Duke përfituar nga drita që u përhap, përcaktoi më mirë pozicionin e topave dhe vuri re se aty më lart ndodhej edhe një tanks, që ai më parë s'e kishte parë. U çua dhe vazhdoi të lëvizte përmes kaçubeve, herë duke vrapuar e herë duke u hequr zvarrë, por gjithmonë me mendimin që të plotësonte sa më parë detyrën dhe të kthehej te shokët.

Dy monarko-fashistë po bisedonin njëri me tjetrin me zë të lartë, xixëjlimi i cigareve tregonte largësinë midis tyre. Zbuluesi që ishte afër, i shtrirë barkaz, po dëgjonte me kujdes dhe mundohej të kuptonte diçka, por më kot, sepse ai nuk e dinte gjuhën. Megjithatë, vuri re se njëri i fliste tjetrit më shumë dhe në mënyrë urdhëruese, kurse tjetri përgjigjej shkurt, e i bindur. Pas pak, ata u ndanë. Ai që mbeti në vend dhe pastaj u kthye poshtë, e nderoi tjetrin dhe këtë zbuluesi e kuptoi nga përplasja e takave të këpucëve, kurse tjetri u nis lart në drejtim të majës së kodrës.

Zbuluesi i shkante monarkofashistit para e djathtas, me shumë kujdes, duke lëvizur i për-kulur. Ferrat dhe degët e thata ja zhvoshkën lëkurën në faqe dhe në ballë dhe gjaku filloi t'i rridhte por ai s'kish atë kohë tashti për të fshirë gjakun, bile as që mendoi të nxirrte shaminë e të pastrohej. Ai i kish vënë vetes tjetër detyrë, pran-

daj, pa e humbur nga sytë monarko-fashistin, ecte drejt majës së kodrës, për ku ngjitej edhe armiku.

Kur monarko-fashisti u afrua pranë një dushku të dendur dhe të ulët, në drejtim të fytyrës së tij, ju shfaq gryka e automatikut. Ai për një çast ribehti i ngrirë në vend, po kur pa ushtarin, që qëndronte para tij me gishtin të këmbëza e automatikut kuptoi gjithshka dhe desh të vraponte anash. Zbuluesi nuk i dha kohë. Ai me një të hedhur si rrufe, e goditi me shqelm në bark. Armiku, pasi rënkoj thellë, u rrëzua duke mbledhur të dy duart në ijë.

Bariu ju hodh sipër dhe po i hiqte revolverin nga këllëfi. Por në sekondë armiku u tendos dhe, duke i rënë fort me grusht në tëmth, e hodhi brinjat ushtarin. «Dhe kjo më duhej, — mendoj zbuluesi, në vend që të kap rob unë, po më kapin mua». Dhe flaku tutje revolverin e monarko-fashistit, që e kish në dorë. Gjaku filloi t'i rridhte nga goja, e shkundi një herë kokën, pastaj u çua në këmbë. Monarko-fashisti e goditi prapë, por goditja e dytë në vend që ta trulloste më tepër, e pruri në vete. Bariu me sa fuqi që kishte e goditi prapë me shqelm monarko-fashistin në ijë. Filloi përleshja. Nga të dy anët këmbeshin goditje të forta, me të vetmin ndryshim se monarko-fashisti godiste për ta vërrarë kundërshtarin e tij, kurse zbuluesi mundahej që, me goditjet e tij, ta dobësonte dhe ta kthente në rob armikun. Monarko-fashisti kishte trup të shëndoshë dhe u qëndronte goditjeve të Bariut. Në një çast, armiku u çua dhe, pasi e pa që nuk mund të dilte me fitore nga ky dyluftim, deshi t'ja mbathte me vrap, por zbuluesi e kapi për këmbë dhe e rrëzoi prapë në tokë. Monarko-fashis-

ti thirri fort, si duket për ndihmë. Bariu e kapi për fyti dhe e shtrëngoi. Prapë filluan goditjet kundër njëri-tjetrit, me se të mundnin. Pasi u lodh shumë, dhe duke patur frikë se në atë vend të mbushur plot me armiq mund t'i vinin në ndihmë ushtarë të tjerë monarko-fashistit, Bariu nxori thikën dhe u bë gati t'ja ngulte në zemër. Por vetëtimthi mendoi: «Ja e vrava këtë, një armik më pak do të kemi, po a ja mbërrita qëllimit, për të cilin erdha? Jo!» U çua shpejt dhe ju vërsul armikut si shqiponja gjahut. E goditi disa herë në bark, dhe prapa kokës pastaj e kapi me dorën e djathtë në vete dhe e shtrëngoi fort. Armiku u shtri, i lëshuar në dorën e zbuluesit, i cili pa humbur kohë i futi në gojë një gur të rrumbullakët që i zuri dora aty në tokë dhe ja lidhi gojën me shami rreth e rreth kokës, pastaj i lidhi duart pas shpine dhe urdhëroi:

— Çohu shpejt, s'kemi kohë!

Armiku rrinte i shtrirë me sytë e shqyer nga tmerri.

— Çohu, se të vrava! — i thirri prapë zbuluesi dhe i drejtoi grykën e automatikut. Armiku nuk lëvizti, por gulçoi si derri i egër kur plagoset. Ushtari ra në hall. Robi ishte i rëndë; në krahë nuk mundi ta ngrinte. Koha nuk priste. «Ç'të bëj me të?» — mendoi zbuluesi dhe ju afrua monarko-fashistit te koka dhe e pa për një çast. «Do ta tremb një herë, vendosi, pastaj, po s'u çua, do ta vras me thikë dhe me vete do të marr kuzinierin».

— Çohu, qen bir qeni, se të vrava! — i thirri me zë të ulët, por të vendosur dhe hoqi me forcë pas shulit e automatikut. Monarko-fashisti, sa dëgjoi tingullin metalik të lëvizjes së shulit, u ngrit

menjëherë dhe priti në këmbë duke u dridhur si purtekë.

— Përpara! — e urdhëroi zbuluesi dhe me tytën e automatikut i tregoi drejtimin nga duhej të ecte, kurse ai e ndoqi pas në një farë distance, saqë ta kishte nën kontroll për çdo të papritur...

* * *

Gjithshka shkoi në rregull.

Gjatë tërë rrugës Bariu ishte menduar. Kthimi po i dukej atij më i vështirë se sa nisja. Kur ai u nis e pati fare të lehtë, i bindur se po bënte detyrën dhe detyra ishte mbi të gjitha. Po tashti, gjatë kthimit, zbuluesin diçka e rëndë po e mundonte dhe e shqetësonte. Vetëm tashti, duke ecur me robin përpara, ai po analizonte me gjakftohtësi veprimin e tij. Sa më shumë i afrohej komandës, aq më e vështirë bëhej për të rruga; megjithatë, ai ecte me shpejtësi.

«Turp i madh, theva rregullat,» analizonte ai. Më mirë të dorëzohet robin dhe të më dënojnë pa më pyetur fare. Si do të justifikohem? Si di rregullat? Dëshira për të ndihmuar në asgjësimin e monarko-fashistave? Po kush nuk e ka këtë dëshirë? Të gjithë mund të shkonin e të bënë ashtu si bëra unë. «Duke menduar kështu, mbërriti para strehimit. Pasi u muar vesh me shokun që bënte roje, ja la robin atij dhe u nis për nga hyrja.

Komandanti e komisari po punonin të përqëndruar. «Të hyj?» — mendoi zbuluesi dhe pas pak u kthye prapë tek roja.

— Pse u ktheve? — e pyeti shoku.

— Më duket se janë të zënë, — ju përgjegj me zë të ulët Bariu.

— Hyrë tashti, po pate për të hyrë, se pastaj do të vijnë oficerët e tjerë nga poshtë. Kanë mbledhje.

Bariu shkoi prapë para hyrjes, qendroi një cast në këmbë, pa fytyrat e komandantit e të komisarit dhe u kthye prapë.

— Pse s'hyn? — ju drejtua roja rreptë. — Për ta mësuar manar na e prure këtë, apo për ta pyetur? — dhe me dorë tregoi robin që qe shtrirë aty pranë.

— Qenka më vështirë kjo se sa të përleshesh me monarko-fashistët, — i tha Bariu dhe, i vendosur hyri në strehim e filloi të raportonte.

Komandanti e komisari, pa dëgjuar ç'thoshte zbuluesi, u çuan në këmbë dhe, të habitur, shikuan fytyrën e tij të mbuluar në gjak.

— Ç'ka ndodhur? — e pyeti komisari.

Bariu uli kokën dhe me sytë e ngulur në tokë, tregoi shpejt mbi veprimin e tij, mbi ç'kishte zbuluar dhe më në fund shtoi:

— Pyeteni robin, shoku komandant, se mos vonohemi, pa mua më dënoni më pas.

Komandantin dhe komisarin i pushtoi një ndjenjë mallëngjimi. Që të dy ishin gati t'i hidheshin e ta përçafonin zbuluesin, por u përmbajtën.

Komisari nxori nga xhepi shaminë dhe i fshiu gjakun.

— Çështjen tënde do ta gjykojmë nesër, para kompanisë. Bjereni robin shpejt! — i tha komandanti.

TAKIM NË LUFTË

Për arësye shërbimi më takoi që të qëndroj pak ditë në fshatin N. Me Halimin shihesha për herë të dytë, por karakteri i tij i hapur më afroi.

— Sa të çlodhen pak qetë, — më tha, ta ndezim një herë dhe të këmbejmë ndonjë fjalë se edhe ti u mërzite dhe nxori qesen e duhanit, mbushi mirë çibukun, e ngjeshi me gishtin e madh dhe e ndezi me eshkë.

— Jo, nuk jam mërzitur. Sa të çlodhem pak e do të nisem.

— Do ta mpleksësh një cigare? Është duhan i mirë, i fortë.

— Të faleminderit, nuk e pi.

Disa hapa larg nesh në një shesh me bar loznin dy fëmijë. U ktheva e po i shikoja sepse më tërhoqi vëmëndjen të thirrurit e njërit prej tyre. Ata po grindeshin keq.

Halimi ju afrua. I qortoi dhe pastaj i këshilloi për t'u pajtuar.

Fëmijët u pajtuan dhe u larguan bashkë.

— Janë vëllezër të shkretën, tha ai duke u ulur pranë meje.

— Ishin vëllezër?!

— Halimi u mendua pak, pastaj me gjysmë zëri tha:

— Ndodh që edhe midis vëllezërve të ketë grindje, bile edhe më të rënda.

Dhe, duke e ngarë fjalën, më tregoi se ç'i kishte ndodhur atij vetë me të vëllain:

«Kemi qenë të varfër sa s'mund të thuhet. Ishim shtatë fëmijë dhe të gjithë për t'u ushqyer. Babai ynë që shumë punëtor. Po ç'të punonte? Ku të punonte? Gjithë — gjithë kishim një arë në mal dhe ca kokë dhi. Mëma gjithashtu që e përpjekur, mundohej të shtynte ditët duke na ushqyer, herë me qull misri, herë me nga një dorë gjizë dhe nganjëherë na bente tavë me lakra e dhallë. Ne ishim mësuar me këtë ushqim, por nganjëherë, sidomos më të vegjëlit, kur shikonin fëmijët e gjitonëve që hanin bukë misri, vinin në shtëpi dhe ja plasnin të qarit duke kërkuar dhe ata bukë. Mëma i merrte në prehër, u fërkonte kokën dhe u lutej të pushonin. Kur nuk pushonin, i trembte duke u thënë se, po të kërkonin bukë, do t'i hante gogoli.

Babait i vinte keq sa i këputej shpirti, po s'kish ç'të bënte. Më kujtohet çfarë mërzie i hip-te kur ai rrinte mbështetur në qoshe pranë zjarrit dhe ne si zogjtë e pulës aty afër hanim me uri nga një copë lakër të pjekur. Ai thithte thellë çibukun dhe ngulte shikimin e tij në ndonjë kongjill zjarri. Kur ne mbaronim, mëma na thoshte që të binim shpejt në rroba për të fjetur, sepse ashtu nuk do të na vinte uri, kurse babai merrte ndonjërin nga ne, e ulte mbi gju dhe vazhdonte të thithte tymin e duhanit nga çibuku që e mbushte herë pas here.

Kështu e kalonim jetën në varfëri të madhe sepse varfëria na u bë rrodhe dhe nuk na ndahej.

Një mbrëmje kur vëllai i madh mbushi pesëmbëdhjetë vjeç, babai, pa e shikuar në sy, i tha:

— Ty, Rustem, të kam gjetur punë, nesër do të nisesh.

Të gjithë u habitëm me këto fjalë të babait dhe çakërritëm sytë duke shikuar herë babanë, herë Rustemin.

— Si të duash, — tha Rustemi dhe uli kokën. Pas pak çoi sytë dhe shikoi babanë. — Po dhitë kush do t'i ruajë?

— Ka këtu edhe për të ruajtur dhitë, — u përgjegj ai prapë pa e shikuar në sy.

— Ç'flet more burrë — ju drejtua mëma. — Këtë çilimi dashke të dërgosh për të na ushqyer? Ky s'është bërë akoma për në kurbet.

— Në mos na ushqeftë ne të paktën do të ushqejë veten e tij, kupton apo jo? Gjer tashti e rrite me qull, por më tutje nuk e shpie dot, — tha babai pak ashpër.

Neve të gjithëve ashtu si mëmës na piku në zemër për Rustemin dhe aq u mallëngjyem, sa u futmë në rroba dhe ja shkrehëm të qarit. E pushtonim atë, e puthnim dhe prapë nuk çmalleshim. Babai nuk na foli fare. Edhe nga sytë e tij të palëvizshëm rrëshqitën, përmes faqeve të fishkura, pikat e lotëve.

Të nesërmen, të gjithë u çuam shpejt. Edhe vëllait më të vogël që s'e kishte mbushur motin, i doli gjumi dhe zvarrisej nëpër këmbët e të tjerëve.

— O Halim! Hajde një çikë, — më thirri Rustemi dhe më hoqi mënjanë. Do të kërkoj një gjë, a do të ma japësh?

— Që tashti, — i thashë dhe fillova të heq këmishën (që unë e kisha më të re dhe e dija që Rustemit ajo i pëlqente më shumë, sepse ma kish-te kërkuar disa herë) po mos të vjen e vogël.

— Jo, jo! Nuk dua këmishën. Dua atë kamën që ke ti.

Unë shpeshherë shkoja tek farkëtari i fshatit, një mik i babait, dhe i ndihmoja duke i hedhur qymyr në zjarr dhe duke i fryrë kudhrës dhe farkëtari që qe burrë shumë i mirë, si shpërblim më bëri një kamë të vogël, por shumë të bukur. Kjo ishte e vetmja gjë, me të cilën unë mburresha para mo-shatarëve të mi.

— Mirë, — i thashë, — ta kam falur dhe pas pak vajta e mora kamën në vendin ku e mbaja fshehur dhe ja futa në gji që të mos ja shikonin.

Kështu me lot në sy u puthëm dhe u ndamë me Rustemin. Ai u nis bashkë me babanë për në një fshat dy ditë larg nga ne dhe u fut atje si shërbëtor te një i pasur. Si shpërblim babai do të merrte dy kuintalë misër në vit.

— Janë pak, zoti Abaz, dy kuintalë për një njeri, — i kish thënë babai agait të Rustemit.

— Një herë për një herë nuk janë pak, — ju përgjegj Abazi. — Të shohim si do të jetë djali. Po na kënaqi ai ne, edhe ne do të kënaqim ty, pastaj mos harro se edhe ushqimi dhe veshja e tij janë mbi mua.

Vitet kalonin njëri pas tjetrit.

Rustemi që i zoti për punë dhe i papërtuar. Ai, të thuash të vërtetën, u bë një djalë i gjallë dhe trim, që e bënte natën ditë. Edhe nga pamja e jashtme nuk kish të sharë. Këto cilësi të tij bëjnë që agai dhe gjithë shtëpia ta duan dhe ta mbajnë

më afër e më mirë se shërbëtorët e tjerë. Ata i besuan shumë gjëra. Kur agai dilte për gjah, domosdo dhe Rustemin do ta merrte me vete, jo për t'i prurë gjahun në shtek si bënin shërbëtorët e tjerë, por për të gjuajtur diku afër tij. Kur ndonjëri nga fshatarët e prishte me aganë, ky me anën e Rustemit do të gjente mënyrë, për t'i bërë ndonjë të keqe. Kështu që Rustemi dalëngadalë u bë shkopi i agait për të goditur fshatarët, bile edhe shërbëtorët, shokët e tij.

Do të mendojë njeriu: «Si Rustemi, që u rrit me qull dhe lakër të ngrerë dorën kundër shokëve të tij»? Kjo nuk kuptohet kollaj nga ata që nuk e kanë provuar në veten e tyre se sa të forta kanë qenë kthetrat e bejlerëve dhe agallarëve për të kapur dhe mbajtur fort njerëzit e varfër që u hynin në punë. Ata e muarën Rustemin të ri, të njomë dhe e përpunuan dhe bënë me të siç u desh qejfi. Fjalët e Abazit: «Ti je i zoti, do bëhesh trim, do të jap tokë e shtëpi, bjeri e mos i kurse rjepacakët që kundërshtojnë, sepse, po s'u hëngre ti kokën atyre, ta hanë ata ty» e të tjera, dhe përkëdheljet e ëmbla të grave të shtëpisë si: «U, more Rustem, gjynah që ke lindur në kasolle, sa i pashëm që je! Ty do të gjejmë këtu ndonjë nuse, zonjë të bukur, yll» e të tjera, ja muarën mendjen fare Rustemit.

Por më tepër nga të gjitha gratë, Rustemin e çmendti motra e agait, që quhej Letë. Ajo qe, o mo-shatare, o pak më e madhe nga ai. Ç'është e vërteta Rustemi ish i pashëm, kishte trup të lidhur e të zhdërvjellët. Po edhe Leta s'kish të sharë, e kishte qëndisur natyra sa s'kish ku të vente më mirë.

Ja, të gjitha këto ja bënë kokën erë tim vëllai dhe ai as pyeste për ne, fare. Megjithatë ba-

bai vazhdonte të merrte rregullisht dy kuinalët e misrit në vit që i takonin si hakë e punës së Rustemit.

Disa herë babai shkoi për të tërhequr që andej Rustemin, por gjithnjë që lodhur kot pa mbaruar punë. Një herë më mori dhe mua me vete.

Shtëpia e agait të Rustemit ish ngritur mbi një majë kodre, në mes ullinjve dhe selvive. Qe një shtëpi e bukur dykatëshe, ndërtuar me gurë të bardhë, të skalitur. Nga të gjitha anët ish rrethuar me mur të lartë. Mbrapa ishin stallat dhe ahuret, ku banonin shërbëtorët.

Atje na pritën mirë, dhe të gjithë e mburrën Rustemin, por për të dhënë nuk na e dhanë. Edhe vetë Rustemit nuk ja kishte qejfi. Nga biseda e tij me babanë unë e kuptova se ai fare pak mendonte për ne dhe për pleqtë që akoma vuanin të zitë e ullirit për bukën e gojës.

Ne ndejtëm atje tri-katër ditë. Gjatë kësaj kohe unë rrija bashkë me Rustemin. Një pasdite Abazi ja bëri me gisht Rustemit që t'i afrohej. Ai i vajti pranë. Unë dëgjova:

— Ai kromashi, Hakiu, akoma nuk na e ka prurë bereqetin. Shko atje e bëje zap që ta mbajë mend, e të marrin shembull edhe të tjerët.

Rustemi hodhi një pushkë të shkurtër itali-ane në krah dhe u nis. Bashkë me të vajta dhe unë.

Te kasollja e Hakiut kishte plot fëmijë që lozin në mes të një oborri tërë baltë. Një grua, që mbante në gji një fëmijë të vogël ishte ulur te dera, kurse një ka i bardhë, i vjetër që qe lidhur pas një gardhi gjysmë të prishur, po përtyppte me përtim ca degë misri, që ja kishin hedhur përpara.

— Ku është Haku? — e pyeti Rustemi gruan, ashpër.

— Në mulli, të keqen, — u përgjegj gruaja dhe u çua e trembur. Kishte një fytyrë sikur kish dalë nga varri, kurse trupin kockë e lëkurë.

— Për të bluar për vete paskeni, por që të dorëzoni bereqetin, që i kini borxh agait, nuk u tepëroka, — i shfryu ai dhe pa pyetur njeri shkoi pranë gardhit, zgjidhi kaun që qe lidhur aty.

— Edhe atë të shkretë helm, hua e muarëm, se na vdiqën fëmija për bukë.

— Edhe për aganë hua të marrësh!

Gruaja ja dha të qarit. Edhe fëmijët, që gjatë kësaj kohe kishin pushuar së lojturi ja plasën ulërimës dhe ju mblodhën përreth kaut.

— Aman mos na e merr kaun, ju lut gruaja, pa do të marrim hua e do t'jua biem. Aman, në ke perëndi.

— Ç'bën kështu, i thashë unë me ngadalë, është turp. Ç'ke ti, të mbeti agai pa bukë? Lerua kaun.

Rustemi bëri sikur s'dëgjoi. U nis duke tërhequr kaun për litari:

— Lerua kaun, — i thashë dhe u hodha e i mora litarin. — Nuk e shikon që po ulërijnë?

— Aq më bën mua. Unë dua bereqetin.

— Ta jap unë, po kaun lerua, mos e merr.

Gruaja pushoi dhe me lot në sy erdhi dhe e mori litarin, ku qe lidhur kau, nga dora ime.

— Për një javë të biesh misrin, more vesh, nuk presim më, — i tha Rustemi.

— Jemi të varfër, more vëlla, — më tha gruaja, kemi fëmijë shumë po s'na beson njeri.

— Sa u kini për t'u dhënë e pyeta.

— Dy kuintalë misër.

U nisëm. Rrugës i kujtova Rustemit se pikërisht kështu erdhën hyzmeqaret e agait në fshatin tonë e na i muarën ato dhi që kishim disa vjet më parë, për borxh. Atëhere mëma jonë duke mbajtur një fëmijë në gji, qante dhe i lutej shërbëtorit, që i vuri përpara dhitë duke i rrahur me shkop. Edhe Rustemi, që qe i vogël qante dhe bërtiste, sa dëgjohej gjer në qiell.

— Harrove se ç'ke qënë, — i thashë dhe tashti u bie në qafë këtyre të varfërve.

— Mos më çaj kokën, — më tha dhe vazhdoi të ecte, duke nxituar në drejtim të shtëpisë së agait.

— Qeni atje ku ha, atje leh. — i thashë. — Prandaj hajde, shkulu nga ahuret e hyzmeqarëve.

— Në ahur fjetsh ti. Unë fle në pallat mbi dyshak me një pëllëmbë pambuk, — m'u përgjegj dhe më shkeli synë me djallëzi.

— Për ty ka mbetur bosh dysheku, — i thashë. — Ty po të të japin një prokof për ta shtruar, t'u thuash njëqind herë falemnderit.

Në mbremje ishim ulur të dy pas portës dhe po bisedonim. Me hapa të ngadaltë u afrua Leta. Mua nuk më shihte.

— Ç'bën këtu, o budalla? — e pyeti Rustemin.

— Ja po rri, — u përgjegj ai shkurt.

Ajo nxori gjirin e majtë, e hoqi me dorë përpara, sa doli i gjithi, pastaj kapi me majën e dy gishtrinjëve thithin e vogël mavi.

— Do të pish qumësht?

Rustemi u inatos pak, por nuk foli.

Leta vuri këmbën në sofa dhe ngriti fustanin

Iart deri në mes të kofshës, kosat i ranë përpara. Rustemi i hodhi një vështrim dhe tha:

— Nuk shikon ti Leta, që këtu ka njerëz të tjerë?

Leta e habitur u rregullua dhe shikoi andej — këndej. Kur më vuri re mua, më pa drejt në sy dhe qeshi.

— Vëllai yt është? Punë e madhe, — tha dhe u largua.

Të nesërmen ne do të iknim. Babai e thirri Rustemin dhe i dëshpëruar mundohej t'i mbushte mendjen që të kthehej në shtëpi.

— Nuk vij, — u përgjegj Rustemi.

— Do të vish si qen, përpara, — i shfryu babai, — se mbete të ngordhësh hyzmeqar.

— Ti më prure, nuk erdha vetë, — ju përgjegj Rustemi.

— Po a e di ti që vuajmë e po vdesim? Ne të pritëm si dritën e syrit që të rriteshe e të merrje drejtimin e shtëpisë, të ushqeje vëllezërit dhe ne pleqtë.

— Ja dhe tashti për ju punoj.

— Në dreq të vejë dhe helm të bëhet buka jote, se nuk e dua, po hajde në shtëpi.

— Të shoh një herë, mund të vij më vonë.

— Ruaju se më duket që i vjen rrotull kësaj bushtrës. Do të ta hanë kokën këta të pabesë, — i tha babai. Rustemi nuk foli, po bëri buzën në gaz.

— Hajde të ikim, më tha mua babai, se s'është për ne, ky ka marrë rrugën e shejtanit.

Shërbëtorët nxuarën misrin që na takonte për të marrë dhe po e ngarkonin në kafshë. Kur të dy mushkat e agait u ngarkuan për t'i marrë ne me vete

dhe ishim gati për t'u nisur, Rustemi vajti pranë babait dhe i tha me zë të lartë:

— Ja, nuk je i kënaqur, që vjen e ngarkon këtë misër të bardhë?

Babain sikur e vrau pika, uli kokën dhe po mendohej. Unë u preka shumë nga fjalët e Rustemit, po dhe kur pashë babanë ashtu, kapa njëren mushkë prej litari dhe pasi bëra nëpër oborr nja dhjetë hapa, u drejtova për te depua e misrit.

— Shkarkoje këtë mushkë — i thashë një shërbëtori — shkarkoje, ky është misri që ju ka juve Hakiu.

Shërbëtorët mbetën të habitur, por unë i hoq dha vetë në tokë thasët me misër.

Babai më shikoi.

— Mirë e ke, paç uratën, more bir, — më tha. — Shkarkoi të dyja. Le t'ja shikojë vetë hairin misrit të agait ky langua.

E shkarkuam dhe mushkën e dytë. Unë, duke u munduar të mbaja zemërimin, i thashë Rustemit:

— Quaje se Hakiu ta dha bereqetin, dhe mos ja kërko më.

U ndamë ftohtë me të dhe ikëm.

* * *

Kishte filluar Lufta nacionalçlirimtare.

Unë isha lidhur me lëvizjen dhe kisha dalë partizan. Atje në çetë me shokët i hapa sytë më mirë dhe e kuptova të keqen që na kishte ardhur e na vinte nga bejlerët dhe agallarët. Atje mësova se ata, duke na shtypur e përçarë ne, të varfërve, e

kishin kollaj të hidhnin vallen sipas qejfit në kur-
rizin tonë.

Pas ca kohe, kur isha partizan, mësova se Abazi, agai i Rustemit na qenka hedhur me ballin dhe qe bërë një nga krerët e tij në atë krahinë. Gjithashtu mësova se një nga trimat më të afërt dhe më besnikë të tij, që mbante gjithmonë me vete, ishte dhe Rustemi.

Gjeta rastin dhe i shkrova një letër vëllait e ja dërgova. I shkrova për rrugën e tradhëtisë që kishte marrë, i thosha të kujtonte varfërinë tonë dhe se ai duhej të luftonte bashkë me ne, të varfërit. I shkrova gjatë, ca me fjalët e mia e ca nga ato që më thoshin shokët.

Pas disa ditësh ai më ktheu përgjigjen. Çfarë nuk më shkruante: «Ti je shitur te të huajtë, te tradhëtarët, kini marrë vajzat maleve», e të tjera.

«Paska shkuar shumë larg, kaq e pati dhe vëllazëria» mendova me vete.

Ja dhashë letrën, ta lexonte, komisarit. Ai e lexoi mirë e mirë pastaj, duke e ngulur vështrimin mbi një pikë, më tha:

— Bejlerët dhe agallarët, more Halim, nuk të shtrydhin vetëm djersën, por të shtrëmbërojnë edhe shpirtin.

Sa herë që komisarit na mblidhte për bisedë politike, si shembull të njeriut që gënjehet e bëhet vegël qorre në duart e armiqve merrte Rustemin.

— Ja Rustemi, — thosh komisarit — biri i një fshatari të varfër, ka marrë urën e zjarrit në dorë e bashkë me ballistët e gjermanët vjen e djeg kasollet e shtëpitë e të varfërve. Ç'e lidh Rustemin me aganë? Ç'do t'i japin agallarët dhe bejlerët për këto shërbime atij dhe shokëve të tij që u shërbejnë si qenër besnikë?

Mua më vinte inat sa s'thuhet. Njeriu mund të jetë qorr e të mos e kuptonte qëllimin e luftës sonë, sepse agai ja tregonte së prapthi por kur ha me një gavetë me okupatorët gjermanë dhe i udhëheq ata shtigjeve për të na vrarë e djegur ne, kjo s'durohet.

* * *

Një ditë plasi lufta me gjermanët dhe ballistët. Po luftë ama, nga ata më të rreptat që ta ka qejfi të marrësh pjesë në të. Ne ishim më pak nga armiqtë, por kjo nuk qe ndonjë gjë e veçantë, zakonisht partizanët në luftime kanë qënë me të paktë në numër nga kundërshtari. Pushkët, automatikët dhe mitralozat qëllonin pa pushim.

Armiqtë kishin zënë ca kodra dominuese dhe kishin bërë edhe llogore. Edhe ne ishim në disa kodra më të ulëta karshi tyre. Qëllonim njëri-tjetrin, po pa lëvizur nga vendi. Ashtu midis krismave të armëve që nga maja e kodrës ku ishin armiqtë, u dëgjua një zë i fortë.

- Kujdes krahun e majtë. Asnjë hap prapa!
- «Oj», ja bëra unë sikur më goditi diçka.
- Ç'ke? — më pyeti një shok që kisha pranë.
- Mos u plagose?
- Jo hiç, — u përgjegjja. — Po më duket si i njohur ai zëri që thirri.
- Qëlllo, qëlllo aty, pa ku e dallon dot në këtë zhurmë zërin e njohur, apo të panjohur, më tha shoku dhe qeshi.
- Mora shenjë mirë e mirë me pushkë majën e kodrës dhe zbraza një krehër fishekësh mbi të.
- Kështu do të rrimë tërë ditën t'i shikojmë

në fytyra ata tradhëtarë, e të harxhojmë fishekë kot? — shfryu një partizan.

Në këtë kohë gojë më gojë erdhi urdhëri për t'u përgatitur për sulm, dhe pas pak u dëgjua zëri i komandantit të çetës:

— Para, partizanë!

— Para, partizanë! — thirri dhe një shoqe dhe qëlloi me automatik.

Zëri i saj i hollë u dëgjua deri larg.

— Prite, moj zonja partizane, prite, — thirri prapë zëri i parë që nga kodra e armikut dhe në çast u dëgjua krisma e një pushke. Plumbi goditi automatikun e shoqes që po qëllonte dhe ajo u rrëzua për tokë. Shoqja pas tronditjes së parë, u çua dhe, duke qëlluar, u sul përpara dhe thirri me sa fuqi që kishte:

— Qëndroni tradhëtarë!

Këtë radhë u binda që ky ishte zë i njohur, por të thellohesha më tej s'pata kohë, sepse të gjithë, duke qëlluar mbi armiqtë, sulmuan përpara.

Bombat fluturonin sa nga njëra anë në anën tjetër. Ballistët dhe gjermanët me zor shkuleshin nga vendi. Ne pothuajse u ngjitëm në kodër. Vura re një gjerman sa një derr që me një mitraloz «Sharrës» po qëllonte shokët. E kisha brinjas.

Më tej ishte shtrirë për tokë si kërmë një ballist me një qylaf dy pëllëmbë të gjatë e me një zhgabë të madhe në mes. Kish mbyllur njerin sy e po shënjonte me pushkën e drejtuar, mbi shoqen partizane që po ngjitej pa e vënë re tradhëtarin. Shpejt drejtova pushkën mbi të dhe bëhesha gati të hiqja gishtin, por ballisti e shkreu pushkën një sekondë më parë. Shoqja ra duke thirrur:

— Oh, më vranë tradhëtarët!

Një shok qëlloi mbi ballistin. Ai nuk lëvizi më, por edhe shoqja jonë trime u plagos rëndë.

— Para, partizanë! — u dëgjua prapë zëri i komandantit.

E zumë majën e kodrës dhe po ndiqnim armiqtë. Disa prej tyre nuk i kishim larg.

— Dorëzohuni! — thirra unë. — Mos ikni me gjermanët!

Një ballist, nga ata që tërhiqeshin të fundit, ndaloi si i hutuar. Unë mendova se desh të dorëzohet dhe u afrova. Por hutimi i tij nuk zgjati shumë. Më pa mirë e mirë pastaj me shpejtësi mbështeti pushkën në sup, mori shenjë mbi mua dhe qëlloi. Unë s'pata kohë të ulem, plumbi i tij ma hodhi larg bustinën time partizane.

— Dorëzohu i poshtër, — i thirra prapë.

— Të dorëzohem unë ty, kulishit të kuq — thirri dhe qëlloi duke e mbajtur grykën e pushkës drejt mbi mua.

E njoha nga zëri që ai qe Rustemi.

— Rustem, dorëzohu, mos ik! — i thirra.

Rustemi ashtu si ishte duke vrapuar, ktheu njëherë kokën nga unë, pastaj e drejtoi pushkën mbi një partizan që i doli më afër dhe qëlloi.

— Rustem, dorëzohu! — i thirra prapë më fort.

Ai ja mbathi vrapit e u bë erë.

Pas disa të shtënash mbi ta, Rustemi u rrëzua. U ngrit prapë, pastaj prapë u rrëzua. Me vrap vajta atje. Më shikonte me një ergësi që s'e tregon dot me fjalë, por nuk foli, vetëm gulçonte, më shumë nga inati se nga dhimbja e plagës.

Plumbi e kish marrë në kofshën e majtë. I preva pantallonat dhe i lidha plagën fort e fort me një shami timen. I hoqa nga brezi kamën, që

i kisha dhuruar kur ai u nis për të vajtur shërbëtor, dhe e vura në brezin tim. Pastaj i mora gjerdanin me fishekë me pushkën dhe i hodha në krah.

— Ja ku të shpie rruga e tradhëtisë që ndoqe, — i thashë.

— Vramë! — më tha dhe nuk foli më, por edhe s'patëm kohë të rrinim shumë, se pas disa minutash ja mbërritën prapë gjermanët dhe ballistat, që filluan të kundërsulmonin.

— Që e meriton, e meriton, bile jo një herë, por shumë herë, — i thashë. Po le të të dënojë gjyqi partizan, dhe dije se po të dënoi me vdekje, plumbin do të ta jap vetë.

— Shpejt kalo mbrapa, më thirri një shok, se mos na rrethojnë.

— Hajde këtu, i fola, të tërheqim një ballist të plagosur.

— Vramë, të them! — bërtiti Rustemi.

— Të plagosurit nuk i vrasim, nuk jemi ballistë, po edhe robërit i gjykojmë dhe vrasim ata që duhen vrarë, e kupton apo jo? — i thashë.

E muarëm të dy me shokun dhe e çuam në një vend ku qenë grumbulluar dhe robërit e tjerë. e lamë atje dhe shpejt u kthyem te shokët që po luftonin.

* * *

Ja kështu ndodh që edhe midis vëllezërve të ketë «grindje». Sa mirë është kur vëllanë e ke edhe shok në luftë për një qëllim të lartë. Por ja që nganjëherë ndodh edhe ndryshe.

Halimi, si mbaroi së treguari, mbushi dhe një herë çibukun, e ngjeshi fort me gishtin e madh dhe pastaj shkrepri me hurora dhe e ndezi.

— Mos të mërzita duke folur kaq gjatë? — më

pyeti. — Ja që ra fjala, pa s'kisha ndër mend t'i kujtoja këto gjëra.

— Jo, ju përgjegja, dhe po mendohesha.

— E po tashti do të më falësh të ngrihem se edhe qetë e hëngrën kashtën — tha Halimi dhe u mat të ngrihej.

— Po mirë, si përfundoi Rustemi, ç'u bë? — e pyeta.

— Rustemi? — Halimi ktheu kokën në drejtim të disa arave ku punonin pendët e qeve të kooperativës, Rustemi ja ku është, e sheh atë bujkun atje, që nget qetë midis kooperativistëve që hedhin farën? — dhe më tregoi me dorë një bujk që punonte nja dyqind metra larg dhe që me hostenin në dorë u thërriste qeve. — Ja ai është.

Duket se fytyra ime tregoi një farë habie. Halimi e vuri re këtë dhe me buzë në gaz vazhdoi:


— Pas luftimit u mbloodhëm, dhe të gjithë ballistët dhe gjermanët e kapur rob kaluan në gjyqin partizan.

Rustemi u gjykua gjatë, por më në fund ja faiën jetën dhe e kaluan nën vërejtje, në komandën e vendit. Siç duket këtu lojti rol dhe ajo që ai ishte i plagosur. Pas çlirimit u gjykua nga gjyqi i popullit dhe u dënua në burg sipas hakut. Tashti ai i është vënë punës si të tjerët, ka gruan dhe fëmijë.

— Po ja kujton ti ndonjëherë të kaluarën?

— Jo, ç'ti kujtosh? Po ndodh ndonjëherë që bën ndonjë gjë ose thotë ndonjë fjalë së prapthi, vetëm atëherë unë e pyes: «Si e ke plagën e këmbës?» Kjo sikur e vë në vijë. Po e drejta është se ka kohë që e ka kuptuar gabimin.

U ndamë me Halimin. Edhe unë ika, kurse ai filloi lehën e re.



PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Pranimi në parti.	3
Miqtë	23
Buka	34
Takimi me Oto Mylerin	43
Grimca nga jeta e një heroi	57
Zbuluesi	67
Takim në luftë	79

54524

